FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2026 – Numri: 146

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 7 korrik 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 6.7.2026	Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor-turistik me përmasa ndërkombëtare.....	13489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 30.6.2026	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030 dhe të planit të veprimit 2026–2028.....	13489
Urdhër i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 292, datë 30.6.2026	Për miratimin e Planit të Veprimit për Ndërkombëtarizimin dhe Integrimin Evropian të Zinxhirit të Vlerës së Industrisë Tekstile, Veshjeve, Lëkurës dhe Këpucëve 2026–2027.....	13688
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 393, datë 3.6.2026	Për delegim kompetence.....	13695
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 83/16, datë 29.6.2026	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim bllok që kufizohet nga rrugët 'Mihal Grameno', 'Todi Shkurti' dhe 'Zonja Curre'".....	13695

AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 6.7.2026

PËR FINANCIMIN E PJESSHËM TË ORGANIZIMIT TË NJË AKTIVITETI KULTUROR-TURISTIK ME PËRMASA NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Financimin e pjesshëm të organizimit dhe të mbarëvajtjes së një aktiviteti kulturor-turistik, me ndikim në promovimin e turizmit dhe të imazhit të Republikës së Shqipërisë, koncerti i artistit të njohur ndërkombëtar, Kanye West (YE), që do të zhvillohet në Tiranë, në datën 11 korrik 2026, në masën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë.

Neni 2

Shuma në masën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, sipas nenit 1, të këtij akti normativ, pakësohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe i shtohet Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit në zërin 604 "Transferta të brendshme", të programit 04760 "Zhvillimi i turizmit".

Neni 3

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit autorizohet të nënshkruajë marrëveshjen përkatëse me kompaninë organizatore të eventit, me qëllim disbursimin e fondit të parashikuar në nenin 1, të këtij akti normativ.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 505, datë 30.6.2026

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA 2026–2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2026–2028

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030 dhe të planit të veprimit 2026–2028, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse, të përcaktuara në strategjinë dhe në planin e veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA 2026–2030
Tiranë, qershor 2026

Pasqyra e lëndës
Lista e shkurtimeve
Pjesa I: konteksti strategjik
1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik
1.2 Vizioni dhe parimet udhëheqëse të strategjisë
1.3 Metodologjia
1.4 Analiza e rreziqeve, arritjet dhe mësimet e nxjerra
Krimet në fushën e narkotikëve
Pavarësisht rënies së prodhimit të brendshëm të kanabisit si rezultat i presionit të ushtruar nga

agjencitë e zbatimit të ligjit dhe intensifikimit të masave monitoruese, fenomeni vijon të mbetet një kërcënim me potencial riaktivizimi.

Korrupsioni

Pastrimi i parasë

Krimet kibernetike

Ndërhyrjet në mënyrë të paligjshme në të dhënat kompjuterike

Mashtrimet *online*

Dhënia e ndihmës për kalime të paligjshme të kufirit

Krimet mjedisore

1.5 Korniza institucionale në fuqi, lidhja me dokumentet strategjike dhe prioritetet

Lidhjet me strategji të tjera sektoriale dhe dokumente vlerësimi të rrezikut

Pjesa II: Qëllimet politike dhe objektivat specifike të dokumentit strategjik

2.1 Qëllimi i politikës I: parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Objektivi specifik 1.1: Rritja e qëndrueshmërisë publike dhe institucionale ndaj krimit të organizuar përmes përmirësimit të ndërgjegjësimit, njohurive dhe angazhimit proaktiv

Objektivi specifik 1.2: Reduktimi i cenueshmërisë së komuniteteve me rrezik, duke përmirësuar aksesin në mekanizmat e mbështetjes sociale, ekonomike dhe të riintegrimit

Objektivi specifik 1.3: Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individëve me rrezik, përfshirë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së

Objektivi specifik 1.4: Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë

Objektivi specifik 1.5: Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit

Objektivi specifik 1.6: Zbatimi i efektshëm i qasjes administrative për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe në administratën publike 63

2.2 QËLLIMI I POLITIKËS II: NDJEKJA PENALE DHE GODITJA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

Objektivi specifik 2.1: Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional 67

Objektivi specifik 2.2: Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe kapaciteteve hetimore

Objektivi specifik 2.3: Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë

Objektivi specifik 2.4: Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Objektivi specifik 2.5: Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave

Objektivi specifik 2.6: Rritja e efektivitetit në gjurmimin, sekuestrim, konfiskimin dhe ripërdorimin e aseteve, duke hequr sistematikisht të ardhurat kriminale dhe duke i riinvestuar për dobi publike

Objektivi specifik 2.7: Përmirësimi i matshëm në hetimet dhe ndjekjet penale të udhëheqësve dhe anëtarëve të strukturave të krimit të organizuar, e demonstruar me rritjen e dënimeve të rënda dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Objektivi specifik 2.8: Reduktimi i ndjeshëm i krimit mjedisor, përmes përmirësimit të mekanizmave të zbulimit, forcimit të kapaciteteve të specializuara hetimore dhe të ndjekjes penale, zhvillimit të hetimeve financiare dhe konfiskimit të përfitimeve të paligjshme, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkufitar

Objektivi specifik 2.9: Rritja efektivitetit të ndjekjes ndërkombëtare të personave të kërkuar, e demonstruar përmes normave më të larta të arrestimit dhe ekzekutimit në kohë të procedurave të ekstradimit

2.3 QËLLIMI I POLITIKËS III: BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Objektivi specifik 3.1: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar përmes rritjes së shkëmbimit të informacionit, operacioneve të përbashkëta, dhe ndërprerjes ndërkufitare të krimit të organizuar

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar përmes shpejtimit të shkëmbimit të informacionit, forcimit të ndjekjes së çështjeve dhe rritjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të huaja
PJESA III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI
3.1 Përgjegjësia e institucioneve
3.2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi
Llogaridhënia
Monitorimi
Zbatimi i përgjegjshëm ndaj gjinisë
Angazhimi dhe Koordinimi i Asistencës së Huaj
Raportimi
PJESA IV: ANALIZA BUXHETORE
Analiza Narrative e Kostove Kapitale
I. Objektivi Specifik 1.2 – Reduktimi i cenueshmërisë së komuniteteve me risk duke përmirësuar aksesin në mekanizmat e mbështetjes sociale, ekonomike dhe të riintegrimit
II. Objektivi Specifik 1.4 – Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë
III. Objektivi Specifik 1.5 – Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit
IV. Objektivi Specifik 2.3 – Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë
V. Objektivi Specifik 2.5 – Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave
VI. Objektivi Specifik 2.6 – Rritja e efektivitetit në gjurmimin, ngrirjen, konfiskimin dhe ripërdorimin e aseteve, duke hequr sistematikisht të ardhurat kriminale dhe duke i riinvestuar për dobi publike
VII. Objektivi Specifik 2.7 – Përmirësimi i matshëm në hetimet dhe ndjekjet penale të udhëheqësve dhe anëtarëve të strukturave të krimit të organizuar, e demonstruar me rritjen e dënimeve të rënda dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore
Aneksi 1 - Korniza ligjore
ANEKSI 2: Plani i Veprimit për periudhën 2026–2028
ANEKSI 3: Pasaporta e treguesve të performancës

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AFIS	Sistemi i Automatizuar i Identifikimit të Gjurmëve të Gishtave
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AIMS	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
ADN	Acidi Deoksiribonukleik
AKSK	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
AMSEVP	Agjencia e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale[1]
AS	Akademia e Sigurisë
BSH	Banka e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DVP	Drejtoritë Vendore të Policisë
EMPACT	Platforma Evropiane Multidisiplinare kundër Kërcënimeve Kriminale
ENFAST	Rrjeti Evropian i Skuadrave Aktive të Kërkimit të Personave në Kërkim
EUDA	Agjencia e Bashkimit Evropian për Drogat
FAST	Njësia e Kapjes së të Personave të Kërkuar nga Drejtësia
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
QKEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
MA	Ministria e Arsimit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MM	Ministria e Mbrojtjes
MTKS	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NjQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
NPS	Lëndët e Reja Psikotrope
PU	Policia Ushtarake
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm

[1] Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (SHKBB) ka ndryshuar emërtimin në **Agjencia e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (AMSEVP)**, në bazë të ligjit nr. 28/2026, "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale", i cili ka hyrë në fuqi më datë 11.4.2026 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64, datë 27.3.2026.

OS	Objektiv Specifik
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PCC SEE	Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore
RAD	Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
Sh.p.k	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SASPAC	Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës
SIENA	Aplikacioni i sigurt për rrjetin e shkëmbimit të informacionit
SKKOKR	Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
QKEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
SMÇ	Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve
SOCTA	Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë
SIPI/IPSIS	Sistemi i Integruar i Informacionit për Planifikimin
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SPH	Skuadrat e Përbashkëta Hetimore
TI	Teknologji e informacionit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
VPN	Rrjeti Privat Virtual
ZRA	Zyra e Rikuperimit të Aseteve

PJESA I
KONTEKSTI STRATEGJIK

1. HYRJA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT STRATEGJIK

Republika e Shqipërisë vazhdon të avancojë agjendën e reformave dhe të harmonizohet gjithnjë e më ngushtë me standardet e Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, krimi i organizuar vazhdon të përbëjë një kërcënim serioz dhe të vazhdueshëm, duke cenuar kohezionin shoqëror, stabilitetin ekonomik dhe konsolidimin e proceseve demokratike në vend. Sfidat që paraqet krimi i organizuar tejkalojnë dimensionin kombëtar, pasi grupet kriminale me lidhje shqiptare kanë zhvilluar rrjete komplekse dhe të mirëstrukturuara që operojnë në mbarë Evropën dhe më gjerë. Këto rrjete janë të përfshira në një gamë të gjerë aktivitetesh kriminale me ndikim të lartë, duke përfshirë trafikimin e lëndëve narkotike, veçanërisht të kokainës, trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandimin e migrantëve, mashtrimet kibernetike, pastrimin e parave dhe korrupsionin. Karakteri transnacional i veprimtarisë së tyre, së bashku me aftësinë për t'u përshtatur ndaj rrethanave të reja, për të shfrytëzuar boshllëqet rregullatore dhe për të depërtuar në ekonominë e ligjshme, përbën një sfidë të konsiderueshme për Shqipërinë dhe partnerët e saj ndërkombëtarë në fushën e sigurisë dhe sundimit të ligjit.

Ndikimet e krimit të organizuar shtrihen në një gamë të gjerë dimensionesh shoqërore, ekonomike dhe institucionale. Rrjetet kriminale shfrytëzojnë dobësitë dhe cenueshmëritë ekzistuese brenda institucioneve publike, sektorëve ekonomikë dhe komuniteteve vendore, duke rritur aftësinë e tyre për të ushtruar ndikim dhe për të siguruar përfitime të paligjshme. Veprimtaria e tyre dëmton besimin e publikut në institucionet shtetërore, cenon sundimin e ligjit dhe kufizon efektivitetin e mekanizmave ligjzbatuese dhe gjyqësore. Këto zhvillime pengojnë progresin e Shqipërisë drejt përmbushjes së kërkesave strikte të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Nivelet e perceptuara dhe reale të kriminalitetit dhe korrupsionit ndikojnë negativisht në legjitimitetin e institucioneve demokratike, duke dobësuar gjithashtu besimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe efektivitetin e bashkëpunimit ndërkufitar. Lufta kundër krimit të organizuar nuk përbën vetëm një prioritet të sigurisë së brendshme, por edhe një kusht thelbësor për forcimin e shtetit të së drejtës, konsolidimin e institucioneve demokratike dhe avancimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, **Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030** është hartuar si një përgjigje gjithëpërfshirëse, e integruar dhe largpamëse, e ndërtuar mbi bazën e përvojës së strategjisë së mëparshme ndërsektoriale për periudhën 2021–2025 dhe Planeve të Veprimit të saj, kjo strategji shënon një riorientim të plotë drejt prioriteteve aktuale dhe prioriteteve afatgjata të shtetit shqiptar në luftën kundër krimit të organizuar. Kjo strategji prezanton një kornizë moderne, të udhëhequr nga inteligjenca dhe të harmonizuar me standardet dhe prioritetet e Bashkimit Evropian, e hartuar për të përmirësuar qëndrueshmërinë e Shqipërisë ndaj formave të konsoliduara dhe atyre në zhvillim të krimit të organizuar. Ky kuadër strategjik mbështetet në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe integron

qasjet me të avancuara në parandalimin e kriminalitetit, mbledhjen e inteligjencës, ndërprerjen e operacioneve kriminale dhe forcimin institucional. Strategjia promovon një qasje proaktive dhe parashikuese, duke kapërcyer modelin tradicional kryesisht reagues dhe të fokusuar në ndërhyrjen pas konsumimit të veprës penale, duke shkuar drejt një modeli që integron masat parandaluese, inteligjencën, hetimin financiar dhe bashkëpunimin e fortë ndërinstitucional, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Kuptueshmëria e thelluar e mjedisit të kërcënimeve është thelbësore për konceptimin e strategjisë. Kjo fillon me një vlerësim të hollësishëm të rreziqeve që krimi i organizuar paraqet për sigurinë publike, zhvillimin ekonomik, integritetin institucional dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë. Ky vlerësim nuk duhet të konsiderohet si një proces statik, por si një mekanizëm i vazhdueshëm dhe dinamik, i aftë të reflektojë transformimin e vazhdueshëm të kërcënimeve kriminale. Për këtë arsye, një kuptim i përditësuar dhe i bazuar në inteligjencë i mjedisit të kërcënimeve është thelbësor për garantimin e politikave efektive, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt parandalimit dhe reduktimit të ndikimit të krimit të organizuar.

Nga ana tjetër, kjo strategji synon politika që fokusohen edhe te grupet e cenueshme të shoqërisë, duke parashikuar ndërhyrje dhe veprime që ndikojnë te këto grupe, veçanërisht te të rinjtë, por edhe duke integruar perspektivën gjinore që udhëheq përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë, politikave gjinore dhe analizave gjinore në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke synuar të harmonizohet me konceptin e Bashkimit Evropian në këtë fushë. Strategjia e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar do të harmonizohet me parimet dhe praktikat e Bashkimit Evropian, përfshirë integrimin e perspektivës gjinore si një komponent transversal i hartimit dhe zbatimit të politikave. Në përputhje me qasjen e BE-së, e cila kërkon politika të ndjeshme ndaj gjinisë në fushën e sigurisë dhe drejtësisë, kjo strategji shqiptare synon të përdorë analiza gjinore, të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe qasje të orientuara drejt nevojave të ndryshme të grave dhe burrave si viktima, përfitues ose aktorë brenda fenomenit të krimit të organizuar. Përfshirja e këtyre elementeve synon të rrisë efektivitetin e ndërhyrjeve, të forcojë institucione dhe t'i bëjë më gjithëpërfshirëse, si dhe të sigurojë një linjë të qartë pajtueshmërie me standardet evropiane brenda kornizës së procesit të integrimit të Shqipërisë në BE.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030 është me rëndësi parësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë dhe shënon një hap të rëndësishëm për shtetin shqiptar në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, përmes zbatimit të këtij dokumenti strategjik, Republika e Shqipërisë përcakton prioritetet e saj politike në ndërtimin e një sistemi efikas për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke specifikuar qëllimet kryesore strategjike, objektivat specifikë dhe përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse shtetërore. Për më tepër, dokumenti strategjik krijon themelet e nevojshme që mundësojnë identifikimin e Shqipërisë në sferën rajonale, evropiane dhe globale, si një aktor i besueshëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Strategjia është në harmoni të plotë me Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024–2026, dhe lidhet konceptualisht me dokumente të tjera strategjike të Republikës së Shqipërisë që adresojnë aspekte të luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, trafikimit të armëve dhe qenieve njerëzore, sigurisë komunitare dhe menaxhimit të integruar të kufijve.

Kjo kornizë e re strategjike siguron pajtueshmëri të plotë me angazhimet e ndërmarra nga institucionet shqiptare në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës – kapitulli 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria" dhe trajton në mënyrë koherente konstatimet e Komisionit Evropian për grupkapitullin e parë "Themelorët" mbi hapat e nevojshëm për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Po ashtu, në qëndrimin e përbashkët të Bashkimit Evropian për grupkapitullin I "Themelorët", u vu theksi te hartimi i strategjisë së re kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda si udhëzues i nevojshëm për vazhdimin e reformave të nisura tashmë, si dhe për

përcaktimin e objektivave të rinj për periudhën e ardhshme. Për më tepër, hartimi i kësaj strategjie është rezultat i një procesi konsultimi gjithëpërfshirës dhe transparent ndërmjet institucioneve publike, agjencive ligjzbatuese, sistemit të drejtësisë, aktorëve të shoqërisë civile, akademisë dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar, duke intensifikuar operacionet policore, duke përmirësuar kapacitetet hetimore dhe duke rritur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë. Arrestimi i elementeve kryesore kriminale, goditja e grupeve kriminale dhe sekuestrimi e konfiskimi i pasurive të tyre kriminale, përbëjnë dëshmi konkrete të këtij progresi. Strategjia e re synon të konsolidojë këto arritje dhe të krijojë një bazë të fortë për një qasje të qëndrueshme dhe të koordinuar në luftën kundër krimit të organizuar.

Kjo **Strategji Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030** përfaqëson angazhimin e palëkundur të Republikës së Shqipërisë për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse një nga sfidat më komplekse dhe më të rëndësishme për sigurinë, zhvillimin ekonomik dhe kohezionin shoqëror të vendit. Duke ushqyer një kulturë parandalimi, duke promovuar standardet më të larta të integritetit institucional dhe duke thelluar bashkëpunimin me partnerët evropianë dhe ndërkombëtarë, Shqipëria pozicionohet si një aktor i besueshëm dhe proaktiv brenda arkitekturës më të gjerë të sigurisë evropiane. Përmes kësaj strategjie, Shqipëria hedh themelet për një të ardhme më të sigurt, më të qëndrueshme dhe më të begatë për të gjithë qytetarët e saj, si dhe kontribuon në përpjekjet më të gjera të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar.

Arritjet e Strategjisë 2021–2025

Strategjia 2021–2025 shënoi disa arritje strukturore dhe operacionale mbi të cilat bazohet kjo Strategji:

- Ngritja dhe konsolidimi operacional i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe i Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me një histori të qëndrueshme padi penale të ngritura dhe dënimesh ndaj figurave të nivelit të lartë të krimit të organizuar.

- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe operacionale të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH). Gjatë vitit 2025 u shënua një progres i rëndësishëm në konsolidimin dhe zgjerimin e kapaciteteve institucionale të Byrosë Kombëtare të Hetimit, me fokus në rritjen e aftësive hetimore, analitike dhe të inteligjencës kriminale në mbështetje të hetimeve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Në kuadër të këtij procesi, struktura e BKH-së u zgjerua me 40 pozicione të reja për hetues. Struktura e miratuar përfshin 100 hetues, 50 oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore, 27 punonjës administrativë dhe 1 pozicion drejtori, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme të kapaciteteve operacionale dhe mbështetëse të institucionit. Njëkohësisht, gjatë muajit tetor 2025 u përfundua me sukses procesi i rekrutimit të 10 Oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, të përzgjedhur nga agjencitë ligjzbatuese në vend, duke kontribuar në forcimin e mëtejshëm të ekspertizës profesionale dhe kapaciteteve të inteligjencës kriminale. Këto zhvillime përfaqësojnë një arritje të rëndësishme në drejtim të rritjes së efektivitetit të hetimeve komplekse kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe pasurive me origjinë kriminale, si dhe të forcimit të përgjithshëm të mekanizmave të specializuar të zbatimit të ligjit në Shqipëri.

- Agjencia e Inteligjencës Financiare ka shënuar progres të konsiderueshëm në forcimin e rolit të saj si institucion kyç në parandalimin dhe goditjen e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Gjatë periudhës 2019–2025, AIF ka referuar pranë organeve ligjzbatuese, përfshirë Policinë e Shtetit, Prokurorinë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, gjithsej 1,911 raste të dyshuara për veprimtari të paligjshme financiare. Ky progres është mbështetur nga një proces i vazhdueshëm forcimi institucional, përfshirë riorganizimin strukturor të ndërmarrë gjatë vitit 2024, zhvillimin e kapaciteteve profesionale të personelit përmes programeve të specializuara të trajnimit dhe zgjerimin e aksesit në databaza dhe burime të avancuara informacioni.

- Rritja operacionale e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të

Konfiskuara (AAPSK), me një portofol asetesh në zgjerim dhe gjeneratën e parë të marrëveshjeve për ripërdorim social me njësitë e qeverisjes vendore.

- Miratimi i ligjit të ri për Policinë e Shtetit (ligji nr. 82/2024) që kornizon modernizimin e Policisë Kriminale, pozicionet e shërbimit të policisë gjyqësore dhe rrugëve të specializimit solli rritjen dhe përmirësimin e kompetencave hetimore të Departamentit të Policisë Kriminale, duke mundësuar profilizimin e tyre me qëllim rritjen e efikasitetit hetimor dhe goditjen e grupeve kriminale.

- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërkufitar, i reflektuar në rezultate të qëndrueshme operacionale, përfshirë sekuestrime të konsiderueshme të kokainës dhe heroinës, goditjen e rrjeteve të trafikimit ndërkombëtar, arrestimin e personave në kërkim ndërkombëtar përmes mekanizmave të INTERPOL-it dhe partnerëve të BE-së, si dhe pjesëmarrjen aktive në operacionet e përbashkëta të zhvilluara në kuadër të prioriteteve të EMPACT-it. Përmirësim i infrastrukturës së provave dhe menaxhimit të çështjeve: progres në vendosjen e *e-Presto* në shërbimin e prokurorisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe SPAK.

- Njohje pozitive e progresit të reformës së drejtësisë në raportet e njëpasnjëshme të progresit të Komisionit Evropian dhe konfirmim i angazhimit operacional nga partnerët ndërkombëtarë (Shtetet Anëtare të BE-së, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Këshilli i Evropës dhe UNODC).

- Njohje e progresit në Raportin e Komisionit Evropian 2025 për Shqipërinë, ku vlerësohet rritja e nivelit të përgatitjes në kuadër të grupapitullit 1 (Themelorët), veçanërisht në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, nga 8.0 në 8.5. Po ashtu, evidentohet përmirësim i mëtejshëm (+0.5) në luftën kundër pastrimit të parave dhe rikuperimit të aseteve, si dhe progres i ndjeshëm (+1.0) në fushën e luftës kundër drogës dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Raporti konfirmon gjithashtu se zbatimi i Strategjisë 2021–2025 ka hyrë në fazat e fundit të realizimit.

- Miratimi i ligjit për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve në qershor 2025 dhe forcimi i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), pozicionet e autorizuara të së cilës u zgjeruan nga 14 në 36 në shtator 2025. Deri më dhjetor 2025, AAPSK administroi 1.679 prona të sekuestruara dhe 546 prona të konfiskuara, me një vlerë të përbashkët prej afërsisht 51,6 milionë eurosh;

- Përqendrim i ndjekjeve penale me ndikim të lartë në SPAK: 871 procedime penale në hetim në vitin 2025 (rritje 4,9% krahasuar me 2024), 220 çështje korrupsioni të regjistruara (rritje 17,7%), 10 zyrtarë të nivelit të lartë të dënuar me vendim të formës së prerë dhe një normë dënimi e Gjykatës së Posaçme prej rreth 87%. Në të gjitha dosjet e SPAK-ut, sekuestrimet dhe konfiskimet totale arritën vlerën rreth 45,4 milionë euro (përfshirë 12,4 milionë euro në kriptovalutë), me 42,4 milionë euro të lidhura me veprat e krimit të organizuar. SPAK-u u plotësua me personelin sipas ligjit, prej 20 prokurorësh të posaçëm, në vitin 2024 dhe operoi me 124 punonjës në vitin 2025, përfshirë 12 hetues financiarë të dedikuar.

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030 (korrik 2024) dhe dalja nga lista gri e FATF-it në tetor 2023. Ky progres shoqërohet me përmirësim të ndjeshëm të përputhshmërisë me 40 Rekomandimet e FATF-it, ku vendi aktualisht vlerësohet me 6 fusha plotësisht në pajtim, 31 kryesisht në pajtim dhe 2 pjesërisht në pajtim, pa asnjë vlerësim mospajtueshmërie të mbetur. Ky zhvillim përfaqëson një përmirësim substancial krahasuar me bazën e vlerësimit të MONEYVAL-it të vitit 2018.

- Thellim operacional i bashkëpunimit ndërkombëtar: Byroja Kombëtarë e Hetimit përgjatë periudhës 2022–2025 ka shkëmbyer 329 informacione policore me partnerët dhe agjencitë e huaja, përfshirë SIENA Europol. Agjencia e Inteligjencës Financiare fitoi akses në platformën SIENA të Europolit, me mesazhet SIENA në rritje me 6,2% në vitin 2024; Shqipëria mori pjesë në 152 çështje të Eurojust ndërmjet marsit 2024 dhe korrikut 2025, kontribuoi në 25 Skuadra të Përbashkëta Hetimore (16 prej të cilave për narkotikët) dhe regjistroi një rritje 25% të operacioneve të përbashkëta përmes INTERPOL-it 24/7 në krahasim me vitin 2023. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike të

marra nga jashtë u rritën 35,7% në vitin 2025 në 95 kërkesa, me 66,3% të ekzekutuara brenda vitit.

- Ngritja e Observatorit Kombëtar të Drogave brenda strukturës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në korrik 2025, si dhe vazhdimi i funksionimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm për substancat e reja psikoaktive brenda Policisë së Shtetit, përbëjnë hapa të rëndësishëm në forcimin e mekanizmave kombëtarë të monitorimit, analizës dhe reagimit ndaj fenomenit të drogës në përputhje me standardet e BE-së. Në të njëjtën kohë, shkatërrimi në rritje të konsiderueshme i kanabisit të paligjshëm i regjistruar në vitin 2024, pasqyron pjekurinë operacionale të masave të zbulimit ajror të zhvilluara me asistencën italiane.

- Në kuadër të forcimit të luftës kundër narkotikëve dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së, kuadri ligjor për lëndët narkotike dhe substancat psikotrope është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme përmes ndryshimeve në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, të ndryshuar, përfshirë amendimet e miratuara gjatë viteve 2023, 2024 dhe së fundmi në vitin 2026. Paralelisht, ndryshimet e vitit 2023 të këtij ligji kanë rregulluar në mënyrë të posaçme kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së kanabisit për qëllime mjekësore dhe industriale, duke parashikuar gjithashtu përparësinë e këtij kuadri mbi dispozitat që bien në kundërshtim me ligjin bazë.

- Ngritja dhe funksionimi i regjistrave që mbështesin gjurmueshmërinë dhe transparencën, si: regjistri qendror i llogarive bankare, regjistri i pronarit përfitues, sistemi noterial NISA, si dhe shënohet progres i ndjeshëm në digjitalizimin e të dhënave për pronat në vend.

Mësimet e nxjerra dhe zgjedhja konceptuale e Strategjisë

Cikli i mëparshëm ka nxjerrë një sërë mësimesh të rëndësishme, të cilat kanë informuar hartimin e kësaj Strategjie. Mësimet kryesore janë paraqitur më poshtë dhe secila prej tyre reflektohet në qasjet dhe orientimet konceptuale të Strategjisë.

- Koordinimi ndërinstitucional është përmirësuar por mbetet i fragmentuar në praktikë: bashkëpunimi *ad-hoc*, aksesi i kufizuar në të dhënat operacionale dhe mungesa e protokolleve plotësisht të sistemuara të ndarjes së të dhënave vazhdojnë të ngadalësojnë hetimet e çështjeve komplekse.

- Sistemet e informacionit nuk janë të unifikuara dhe janë vetëm pjesërisht të ndërveprueshme. Për sistemet *e-Presto,* Sistemet e Menaxhimit të Çështjeve dhe bazat e të dhënave operacionale, është e nevojshme të përfundohet zhvillimi i moduleve të papërfunduara dhe të sigurohet ndërveprueshmëria e plotë e sistemeve nga fillimi deri në fund të proceseve përpara se të mund të mbështesin operacionet rutinore të udhëhequra nga inteligjenca. Procesi i rikuperimit të aseteve ka pasur zhvillime pozitive në bashkëpunim ndërinstitucional, ndërmjet strukturave përgjegjëse, ndërkohë që mbetet i nevojshëm forcimi i mëtejshëm i koordinimit operacional, kapaciteteve analitike dhe standardizimit të praktikave të referimit dhe reagimit.

- Megjithëse janë forcuar kapacitetet parandaluese në disa fusha, mbetet sfidë rritja e efektivitetit të ndjekjes penale dhe finalizimit nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Ndërsa cikli i mëparshëm fokusohej drejt ndjekjes penale; kjo Strategji zgjeron shtyllën parandaluese në gjashtë objektiva specifikë, përfshirë qëndrueshmërinë komunitare dhe parandalimin administrativ.

- Kërcënimet kriminale evoluojnë më shpejt se përgjigjja strategjike: krimi kibernetik, krimi i mundësuar nga kriptovalutat, krimi mjedisor dhe mashtrimi në internet janë zgjeruar përtej asaj që strategjia e mëparshme parashikonte, duke justifikuar objektiva specifikë të dedikuar në këtë Strategji dhe një mekanizëm rishikimi në mes të periudhës së zbatimit të saj.

- Bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor, por procedurialisht i ngadaltë: afatet kohore të ekstradimit dhe vonesat e ndihmës së ndërsjellë juridike (letër-porositë), e zvogëlojnë vlerën operacionale të bashkëpunimit të operacioneve të udhëhequra nga inteligjenca. Kjo Strategji prioritizon praninë e oficerëve të ndërlidhjes, protokollet e Skuadrave të Përbashkëta Hetimore (SPH) dhe koordinimin me Eurojust.

- Dimensioni gjinor i krimit të organizuar, qoftë si faktor cenueshmërie, ashtu edhe si kënd analitik, nuk ishte i zhvilluar mjaftueshëm në strategjinë e mëparshme. Kjo Strategji integron analizën e përgjegjshme gjinore dhe të dhënat e

ndara sipas gjinisë në Qëllimet e Politikave I dhe II.

1.2 VIZIONI DHE PARIMET UDHËHEQËSE TË STRATEGJISË

Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të shërbejë si udhëzues për mobilizimin e të gjitha strukturave për t'iu përgjigjur grupeve dhe individëve kriminalë, duke harmonizuar ndërveprimin ndërmjet qeverisë, sektorit privat, organizatave jofitimprurëse, shoqërisë civile, komunitetit dhe qytetarëve. Vizioni i saj është si vijon:

"Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar të drejtat individuale, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësinë e saj".

Ky vizion është në përputhje dhe në harmoni të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE 2030), ku lufta kundër krimit të organizuar lidhet specifikisht me shtyllën e parë të saj "*Demokracia dhe forcimi i institucioneve dhe qeverisja e mirë*" , në të cilën nevoja për forcim të mëtejshëm të institucioneve efikase të vendit përshkruhet si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në "familjen e madhe" të Bashkimit Evropian. Sfidat e parashikuara nga kjo strategji lidhen gjithashtu me sfidat e paraqitura në SKZHIE 2030 *"Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësinë e saj".*

Shqipëria aspiron të jetë një shoqëri ku krimi i organizuar parandalohet sistematikisht, ndiqet penalisht me shpejtësi dhe goditet në mënyrë efektive; ku të ardhurat e krimit gjurmohen, konfiskohen dhe ripërdoren në mënyrë të besueshme për të mirën publike; dhe ku institucionet kombëtare bashkëpunojnë në mënyrë të papërcaktuar me homologët e tyre evropianë dhe ndërkombëtarë në mbrojtjen e sundimit të ligjit dhe sigurisë së qytetarëve. Strategjia është ndërtuar mbi parimet e mëposhtme udhëheqëse:

- Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut: çdo masë është në përputhje me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore, dhe respekton prezumimin e pafajësisë, procesin e rregullt ligjor dhe mbrojtjen gjyqësore efektive.
- Veprim i udhëhequr nga inteligjenca: parandalimi dhe zbatimi udhëhiqen nga vlerësimi i strukturuar i kërcënimit, hetimi paralel financiar dhe modelimi i ndërprerjes, dhe jo vetëm nga praktika reaguese rast pas rasti.
- Koordinimi ndërinstitucional: zbatimi realizohet përmes protokolleve të formalizuara të ndarjes së informacionit, sistemeve të standardizuara të të dhënave dhe strukturave të përbashkëta operacionale, kurrë përmes bashkëpunimit *ad-hoc*.
- Konceptim i përgjegjshëm ndaj gjinisë: masat e parandalimit, mbrojtjes dhe riintegrimit dizajnohen dhe monitorohen me të dhëna të ndara sipas gjinisë; dimensioni gjinor i krimit të organizuar trajtohet si faktor cenueshmërie, ashtu edhe si lente analitike.
- Harmonizimi me *Acquis* të BE-së: çdo Objektiv Specifik është i harmonizuar në *Acquis* përkatëse të Kapitullit 24 dhe kornizat operacionale të BE-së (Europol, Eurojust, EMPACT, ENFAST).
- Bashkëpunimi ndërkombëtar si praktikë rutinë: bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh integrohet në operacionet kombëtare si praktikë standarde dhe jo si shtesë e jashtëzakonshme.
- Monitorimi i bazuar në të dhëna: progresi matet kundrejt treguesve me vlera bazë të vendosura dhe synime për vitin 2030, dhe rishikohet në mënyrë të pavarur në mes të periudhës së zbatimit në vitin 2027.
- Transparenca dhe llogaridhënia: raportet monitoruese dhe vlerësuese të zbatimit janë publike dhe angazhimi me shoqërinë civile dhe akademikët është i strukturuar dhe jo i rastësishëm.

1.3 METODOLOGJIA

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 bazohet mbi një metodologji të fortë, të integruar dhe të bazuar në të dhëna. Kjo qasje integron analizën e kërcënimit, vlerësimin institucional, arkitekturën operacionale, zhvillimin e kapaciteteve, ndërprerjen financiare të krimit dhe bashkë-punimin ndërinstitucional si shtyllat themelore të

zbatimit, si dhe konsultim të gjerë për të siguruar si koherencën ashtu edhe efektivitetin.

Rishikimi tërësor i peizazhit institucional të Shqipërisë nxjerr në pah pikat e forta, boshllëqet dhe nevojat për kapacitete në të gjithë organet ligjzbatuese, të drejtësisë, rregullatore dhe të mbikëqyrjes. Ky vlerësim përcakton ku duhet të zhvillohen kapacitetet, në mënyrë që institucionet të jenë të përgatitur për t'u përgjigjur. Krimi financiar dhe ekonomik trajtohet si prioritet ndërsektorial në të gjithë qëllimet politike. Përveç pastrimit të parave, kjo përfshin krimet tatimore, keqpërdorimin e bizneseve, skemat mashtruese, flukset e paligjshme financiare dhe mekanizmat e fshehjes së aseteve. Të gjitha hetimet kryesore shoqërohen dhe mbështeten në hetime paralele financiare, me qëllim sigurimin e ndërprerjes sistematike të përfitimeve kriminale si qasje qendrore për goditjen e krimit të organizuar.

Procesi i hartimit të kësaj strategjie është kryer mbi bazën e një metodologjie të integruar brenda kornizës së Planit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024–2026, si dhe angazhimeve përkatëse brenda kornizës së Procesit të Berlinit dhe mekanizmave të monitorimit të BE-së dhe OKB-së. Duke përdorur metodologjinë e Europolit, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë (SOCTA), strategjia operacionalizon në mënyrë të qartë zinxhirin e rezultateve: → Kërcënim → Prioritet → Objektiv → Veprim → Rezultat → Ndikim, duke siguruar gjurmueshmëri të plotë midis rreziqeve të identifikuara dhe ndërhyrjeve strategjike.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar përbën një shtyllë thelbësore mundësuese të strategjisë. Efektiviteti i policimit të udhëhequr nga inteligjenca, hetimet financiare, ndërprerja administrative dhe masat e parandalimit varen nga shkëmbimi i informacionit në kohë reale, sistemet e ndërvepruara dhe strukturat operacionale të koordinuara. Strategjia për këtë arsye prioritizon njësitë e përbashkëta analitike, bazat e të dhënave të integruara dhe protokollet e formalizuara të bashkëpunimit në të gjitha institucionet.

Dokumenti është hartuar përmes një procesi konsultimi gjithëpërfshirës, të koordinuar në të gjitha fazat e tij nga Ministria e Punëve të Brendshme, si institucioni përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, duke filluar nga analiza e rrezikut deri tek miratimi përfundimtar.

Ky proces është kryer në bashkëpunim me institucione të tjera përkatëse, si strukturat e varësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, AAPSK), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Arsimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, (Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Shërbimi Informativ i Shtetit, Byroja Kombëtare e Hetimit, Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Shoqëria Civile, OJF-të, Organet Ndërkombëtare (ICITAP, Këshilli i Evropës, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri) dhe media.

Gjatë hartimit të strategjisë, përkrah infrastrukturës ligjore dhe programeve të ndryshme shtetërore, analiza për vlerësimin e situatës aktuale dhe identifikimin e prioriteteve dhe objektivave të ardhshëm ka marrë në konsideratë gjithashtu praktikat më të mira të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë, rekomandimet dhe konstatimet e raporteve të progresit të Komisionit Evropian dhe mekanizmat e monitorimit të kapitullit 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria), Komiteti i Stabilizim-Asociimit, GRETA, Task-Forca për Veprimin Financiar (FATF), Grupi i Punës për Masat kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (ICRG), dhe Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara (DASH), Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë (SOCTA 2026) si dhe Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (NRA), duke i siguruar kështu dokumentit një bazë të gjerë për zbatimin e tij më efektiv.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar procesit të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim sigurimin e një qasjeje të harmonizuar gjatë hartimit të masave të përfshira

në këtë dokument strategjik. Kjo qasje ka synuar të shmangë mbivendosjen, përsëritjen ose fragmentimin e masave me dokumente të tjera strategjike në fuqi, veçanërisht në fushat e pastrimit të parave, luftës kundër financimit të terrorizmit, parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, ose kontrollit dhe menaxhimit të armëve të vogla dhe të lehta.

Ky proces siguroi që masat e propozuara të jenë plotësuese dhe në përputhshmëri me prioritetet kombëtare, duke mundësuar koordinim më të mirë midis institucioneve zbatuese dhe duke rritur efektivitetin e përgjithshëm të politikave të sigurisë.

1.4 ANALIZA E RREZIQEVE, ARRITJET DHE MËSIMET E NXJERRA

Strategjia është hartuar mbi një analizë gjithëpërfshirëse **të kërcënimeve**, një **sintezë të arritjeve strategjike**, dhe një **rishikim kritik të mësimeve të nxjerra** në luftën e Shqipërisë kundër krimit të organizuar nga viti 2021 në vitin 2025. Për identifikimin dhe analizimin e kërcënimeve që burojnë nga krimi i organizuar dhe i rëndë është marrë në referencë dokumenti "Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë" (SOCTA), i cili përbën produktin kryesor analitik strategjik në këtë fushë. Ky dokument identifikon, analizon dhe vlerëson kërcënimet kriminale nëpërmjet përdorimit të informacionit të përditësuar dhe metodologjive bashkëkohore të analizës së inteligjencës. Referuar metodologjisë së përdorur, **fushat e krimit të organizuar dhe të rëndë** (aktivitetet kriminale), **grupet kriminale** dhe **mjedisi rrethues** janë tri çështjet kryesore te të cilat fokusohet analiza për vlerësimin e kërcënimit të krimit të organizuar dhe të rëndë.

Në kërcënimet kryesore të identifikuara në këtë raport, përfshihen: **grupet kriminale**, të cilët përfaqësojnë aktorin kryesor që gjeneron dhe zhvillon aktivitetet e krimit të organizuar; fushat më tradicionale të krimit si aktivitetet në fushën e narkotikëve, aktiviteti i dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm ndërkufitar; fushat e krimit të cilat zhvillohen kryesisht në sferën digjitale dhe *online*; fusha krimi që funksionojnë si "infrastrukturë mbështetëse" e krimit të organizuar, siç janë korrupsioni dhe pastrimi i parasë, të cilat nuk përbëjnë vetëm aktivitete kriminale më vete, por funksionojnë si faktorë katalizatorë që përforcojnë dhe përshpejtojnë zhvillimin e fenomeneve të tjera kriminale.

Krimet tradicionale, si prodhimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike, korrupsioni, pastrimi parasë, ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, vijojnë të ndikojnë në panoramën e kriminalitetit për shkak të përhapjes së gjerë, ndikimit ekonomik dhe lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë me grupet e organizuara kriminale. Megjithatë, paralelisht me këto fenomene, krimet kibernetike po marrin një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mjedisin e sigurisë, jo domosdoshmërisht për nga numri i rasteve, por për shkak të ndikimit të lartë që mund të sjellin. Zhvillimi teknologjik dhe digjitalizimi i shërbimeve kanë rritur ekspozimin ndaj kërcënimeve kibernetike, ndërsa grupet kriminale dhe aktorët të tjerë po përdorin gjithnjë e më shumë hapësirën kibernetike për mashtrime, vjedhje të dhënash, ndërhyrje në sisteme dhe mbështetje të aktiviteteve tradicionale kriminale.

Në këtë kontekst, edhe pse krimet tradicionale mbeten dominuese, rëndësia strategjike dhe ndikimi potencial i krimeve kibernetike pritet të rritet në mënyrë progresive.

Ndërsa krimet mjedisore, për herë të parë janë objekt i analizës së SOCTA-s. Ato vlerësohen si **kërcënim në zhvillim** që kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm. Edhe pse aktualisht ato mund të mos paraqiten me të njëjtin nivel përhapjeje si format tradicionale të kriminalitetit, natyra dhe pasojat e tyre afatgjata i bëjnë këto veprimtari një rrezik në rritje për sigurinë, ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Bazuar në rezultatin e një analizë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve kriminale, të grupeve kriminale dhe faktorëve të jashtëm që nxisin, mundësojnë dhe lehtësojnë zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kriminale në fushën e narkotikëve (trafikimi kokainës dhe kultivimi, prodhim trafikim kanabis), korrupsioni, pastrimi i parasë, krimet kibernetike si dhe dhënia e ndihmës për kalime të paligjshme të kufirit.

Grupet e krimit të organizuar përbëjnë një **kërcënim** të vazhdueshëm dhe kompleks, për shkak të kapacitetit të tyre për të gjeneruar fitime të konsiderueshme, për të operuar në disa fusha kriminale me shtrirje transnacionale, për të depërtuar në ekonomi dhe për të përdorur korrupsionin dhe dhunën me qëllim ruajtjen e kontrollit. **Evoluimi** i tyre karakterizohet nga një

përshtatshmëri e lartë ndaj presionit të zbatimit të ligjit, duke përfshirë zhvendosje të rrugëve dhe përdorimin e mënyrave të reja të veprimit, zhvendosjen drejt strukturave më fleksible dhe më pak të dukshme dhe përdorimin e teknologjisë (përdorimi i komunikimeve të enkriptuara, transfertat e parave kalojnë edhe nëpërmjet portofolave digjital). Konstatohet tendenca për zhvillimin e aktiviteteve dytësore krahas atyre kryesore, konkretisht është konstatuar një rritje e veprimtarisë kriminale të pastrimit të produkteve të veprës penale si dhe fshehje e të ardhurave, si aktivitet dytësor i grupeve. Shumica e aktiviteteve të rënda kriminale të këtyre grupeve kriminale (kryesisht në fushën e narkotikëve) zhvillohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa Shqipëria përdoret kryesisht për pastrimin e produkteve të veprës penale, si vend tranziti dhe së fundmi edhe si qendër koordinimi e aktiviteteve kriminale.

Krimet në fushën e narkotikëve

Prodhimi dhe trafikimi i narkotikëve është aktivitet dinamik, dominues mbi aktivitetet e tjera kriminale dhe është njëkohësisht edhe më fitimprurësi. Në zhvillimin e aktivitetit të narkotikëve në periudhën 2-vjeçare 2024-2025 janë përfshirë një numër i konsiderueshëm i grupeve të krimit të organizuar, rreth 58% e grupeve kriminale që kanë vepruar në shkallë vendi.

Që nga viti 2020 aktiviteti i kokainës në Shqipëri shfaqet mjaft dinamik, herë me tendenca zgjerimi dhe herë të tjera me zvogëlim të fushës së aktivitetit në varësi të tregut të blerjes dhe shitjes, si dhe të grupeve kriminale të përfshira në zhvillimin e këtij aktivitetit. Në vitin 2025 aktiviteti kriminal i tregtimit të kokainës është rritur ndjeshëm shprehur me rritjen e numrit të rasteve të evidencuara me gati 27.6%. Megjithatë, pavarësisht rritjes së rasteve të identifikuara, sasitë e sekuestruara kanë shënuar ulje, çka mund të tregojë një ndryshim të mënyrës së operimit të rrjeteve kriminale. Kjo situatë vlerësohet të jetë e lidhur si me presionin e shtuar nga strukturat ligjzbatuese, ashtu edhe me sofistikimin e modus operandi të grupeve kriminale, të cilat po adaptohen përmes metodave më të fshehta të trafikimit dhe përpunimit të lëndës narkotike.

Trafikimi i kokainës përbën një nga **kërcënimet** më të rëndësishme të krimit të organizuar, për shkak të fitimeve të larta dhe lidhjeve të forta me rrjete kriminale transnacionale, është burimi kryesor i financimit për krimin e organizuar. Ndryshimi i vazhdueshëm në modus operandi dhe rrugë të përdorura për trafikim rrit më tej kërcënimin për shkak të paparashikueshmërisë së këtij aktiviteti. Gjithashtu një tjetër kërcënim është dhuna e përdorur nga grupet e trafikimit të kokainës për shkak të konflikteve që vijnë nga aktiviteti kriminal.

Ndikimi i trafikimit të kokainës shtrihet në disa dimensione, duke përfshirë rritjen e fuqisë së grupeve kriminale; përhapjen e korrupsionit dhe pastrimit të parave në ndërtim turizëm etj.; Riinvestimi i sasive të larta të të ardhurave të paligjshme dhe injektimi i tyre në sektorë të ndryshëm të shoqërisë, rritjen e rreziqeve për sigurinë publike për shkak të dhunës që përdorin grupet e përfshira në këtë aktivitet me përdorim edhe të armëve dhe së fundi përfshirjen e të rinjve në shpërndarje dhe tregtim të kokainës në doza konsumi.

- **Kanabis**

Analizat e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) e rendisin Shqipërinë ndër vendet më të përmendura për origjinën, nisjen dhe tranzitin e kanabisit në shkallë globale gjatë dekadës së fundit, duke e pozicionuar atë në nivele të larta krahasuese në raport me vendet e tjera evropiane[2].

Në nivel kombëtar, i ndikuar nga një kombinim faktorësh ekonomikë, gjeografikë dhe social, kanabisi mbetet lënda narkotike më e përhapur dhe më e përdorur në vend. Kultivimi i tij është evidentuar prej vitesh në zona të ndryshme të vendit, duke krijuar jo vetëm një traditë të konsoliduar të kultivimit, por edhe njohuri dhe përvojë të vazhdueshme tek individë dhe grupe të përfshira në këtë aktivitet. Kërkesa e vazhdueshme në tregun vendas dhe të huaj e kanë bërë kanabisin një nga aktivitetet kriminale shumë tërheqës për grupet kriminale.

[2] https://www.unodc.org/unodc/data-and-analysis/world-drug-report-2024.html

Disponueshmëria e lartë në tregun vendas, çmimi më i ulët krahasuar me drogat e tjera dhe perceptimi i ulët i rrezikshmërisë te përdoruesit kanë ndikuar që kanabisi të mbetet droga më e përdorur në vend.

Pavarësisht rënies së prodhimit të brendshëm të kanabisit si rezultat i presionit të ushtruar nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe intensifikimit të masave monitoruese, fenomeni vijon të mbetet një kërcënim me potencial riaktivizimi.

Duke marrë në konsideratë kërkesën e vazhdueshme të tregut evropian për këtë lloj droge, si edhe përfitimet e larta ekonomike që gjeneron kjo veprimtari, ekziston mundësia që grupet kriminale të tentojnë zgjerimin e aktivitetit në forma më të sofistikuara dhe më të vështira për t'u identifikuar.

Fusha e politikave të drogës do të trajtohet përmes një procesi të dedikuar strategjik, i cili synon krijimin e një kuadri të unifikuar dhe gjithëpërfshirës në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, ka iniciuar procesi për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Drogave 2030 dhe Planit të saj shoqërues të Veprimit, aktualisht në zhvillim, në zbatim të urdhrit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 42, datë 22.01.2026 "Për ngritjen e grupit ndërsektorial të punës përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti strategjik". Brenda kësaj kornize, strategjia synon të konsolidojë në një qasje të vetme dhe të integruar shtyllat e reduktimit të ofertës, reduktimit të kërkesës dhe reduktimit të dëmit, duke siguruar koordinim efektiv ndërinstitucional, mekanizma të fuqizuar monitorimi dhe përafrim të plotë me kuadrin strategjik të përditësuar të Bashkimit Evropian në fushën e drogës.

Korrupsioni

Korrupsioni përbën **një nga kërcënimet më të rëndësishme**, i cili ka evoluar drejt formave më të sofistikuara dhe të fshehta, duke prodhuar ndikime të ndjeshme në institucionet, ekonominë dhe sigurinë publike dhe duke shërbyer si një mekanizëm kyç që mundëson zgjerimin e krimit të organizuar. Ky fenomen përdoret për përfitime personale, manipulim të procedurave ligjore dhe keqpërdorim të fondeve publike, si dhe për pastrimin e të ardhurave të paligjshme. Kalimi nga korrupsioni i drejtpërdrejtë dhe i dukshëm në forma më të sofistikuara, dhe më pak të dukshme, si: përdorimi i ndërmjetësve dhe rrjeteve të tërthorta[3], struktura financiare më të ndërlikuara *(offshore,* kompani fiktive), ndërthurja me krimin ekonomik dhe konfliktet e interesit.

Pastrimi i parasë

Pastrimi i parave është vlerësuar si një nga **kërcënimet kryesore**, **pasi përbën një mekanizëm mundësues thelbësor për krimin e organizuar**. Ai u lejon kriminelëve të legjitimojnë të ardhurat e aktiviteteve të tyre të paligjshme dhe të integrojnë fondet e paligjshme në ekonominë legjitime duke siguruar një rrjedhë të vazhdueshme fondesh për të financuar operacione të mëtejshme kriminale, për të zgjeruar ndikimin e tyre ose për të shtuar pasurinë e tyre personale.

Pastrimi i parasë ka evoluar nga metoda tradicionale drejt skemave me komplekse me shtirje ndërkombëtare. Gjatë viteve të fundit, evidentohet një model i integruar i pastrimit të parave, i lidhur ngushtë me aktivitete kryesore kriminale nga të cilat kanë burimin këto të ardhura kriminale, si trafiku i narkotikëve, trafiku i armëve, emigrimi i paligjshëm, trafikimi i qenieve njerëzore dhe skemat mashtruese financiare. Skemat e pastrimit karakterizohen nga diversifikimi i kanaleve të transferimit dhe maskimit të fondeve, duke përfshirë sisteme informale të transferimit të vlerave *(Hawala)*, përdorimin e kriptovalutave, qarkullimin intensive të parasë *cash* dhe fragmentimin e transaksioneve për të shmangur raportimin financiar.

(*Për ta ilustruar, në vitin 2024 janë vërejtur **13** tipologji[4] të konsideruara me rrezik për pastrim parash dhe të referuara në organet ligj zbatuese për hetime të mëtejshme, kundrejt 7 tipologjive të konstatuara në dy vitet e mëparshme.)*

Krimet kibernetike

Krimet kibernetike janë rritur me 98%, pothuajse dyfishi i atyre të evidentuara në periudhën 2022–2023. Kjo rritje progresive e numrit të rasteve është ndikuar nga ndërthurja e tre faktorëve kryesorë: përhapja e gjerë e teknologjisë, evoluimi i metodave kriminale dhe

[3] *Rrjete të tërthorta u referohen marrëdhënieve jo të drejtpërdrejta.*

[4] *Raporti Vjetor 2024 i Agjencisë së Inteligjencës Financiare, faqe 33–50.*

mungesa relative e ndërgjegjësimit dhe edukimit në fushën e sigurisë së informacionit.

Krimet kompjuterike po evoluojnë si në shtrirje, ashtu edhe në kompleksitet dhe ndikim, duke kërkuar qasje gjithnjë e më të avancuara në parandalim dhe hetim.

Krimi kibernetik sot është një infrastrukturë mbështetëse për krimin e organizuar tradicional. Ai nuk është vetëm një krim më vete, por një mjet që lehtëson, përshpejton dhe fsheh aktivitete si pastrimi i parave, aktivitete në fushën trafiqeve të paligjshme, migracioni i parregullt etj. Ai e bën pastrimin e parave më të fshehtë, trafikun më global, migracionin e parregullt më të koordinuar etj.

Ndërhyrjet në mënyrë të paligjshme në të dhënat kompjuterike

Ndërhyrjet në të dhënat kompjuterike përbëjnë një **kërcënim në rritje** për sigurinë publike, ekonominë dhe funksionimin e institucioneve shtetërore. Këto veprime përfshijnë aksesin e paautorizuar, manipulimin, fshirjen, dëmtimin ose bllokimin e sistemeve dhe të dhënave kompjuterike, duke cenuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e informacionit. Kërcënimi bëhet veçanërisht i rëndësishëm për shkak të varësisë së lartë të institucioneve, bizneseve dhe shërbimeve kritike nga teknologjia dhe infrastruktura digjitale.

Sulmet kibernetike, që përfshihen në këtë vepër penale zënë një vend kyç jo domosdoshmërisht për shkak të frekuencës së tyre, por për shkak të ndikimit të lartë që mund të prodhojnë ndaj institucioneve, infrastrukturave kritike dhe sigurisë kombëtare. Ato përfaqësojnë një **kërcënim me intensitet të lartë**, ku raporti **"numër i ulët-ndikim i lartë"** i vendos ato në kategorinë e rreziqeve prioritare. Ato kanë kaluar nga forma të thjeshta të dëmtimit ose vjedhjes së të dhënave në operacione komplekse që përfshijnë *ransomware*, sabotim të sistemeve dhe sulme ndaj infrastrukturave kritike.

Pornografia *online* me të mitur

Përfshin prodhimin, shpërndarjen, posedimin dhe shkëmbimin e materialeve me përmbajtje seksuale me të mitur përmes platformave digjitale dhe rrjeteve sociale. Viktimat janë kryesisht fëmijë dhe adoleshentë, të ekspozuar ndaj *grooming*, shantazhit seksual dhe abuzimit *online*. Fenomeni favorizohet nga anonimiteti i internetit, përdorimi i pakontrolluar i teknologjisë dhe mungesa e edukimit digjital. Karakterizohet nga vështirësi hetimore, për shkak të natyrës transnacionale, enkriptimit dhe serverëve jashtë territorit të Shqipërisë. Evoluimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të manipulimit digjital shton më tej kompleksitetin e kërcënimit, duke krijuar forma të reja të abuzimit.

Mashtrimet *online*

Mashtrimet *online* përfshijnë përdorimin e platformave digjitale për përfitime të paligjshme financiare përmes mashtrimeve me pagesa elektronike, *phishing*-ut, identiteteve të rreme, investimeve fiktive, dhe formave të tjera të manipulimit *online*. Kriptomonedha shfaqet si një metodë pagese dhe si një produkt mashtrimi investimi. Mashtrimi i investimeve dhe kompromettimi i *email*-eve të biznesit mbeten skemat më të përdorshme të mashtrimit *online*. **Evoluimi i ardhshëm** i këtyre krimeve pritet të lidhet ngushtë me zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin në rritje të shërbimeve. Pritet rritje e përdorimit të *"deepfake",* mesazheve të personalizuara dhe platformave të enkriptuara për realizimin e mashtrimeve më komplekse. Gjithashtu, përdorimi i kriptomonedhave mund të krijojnë hapësira të reja për fshehjen e gjurmëve financiare dhe transferimin e fitimeve të paligjshme.

Dhënia e ndihmës për kalime të paligjshme të kufirit

Dhënia e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit vazhdon të jetë një aktivitet kriminal tërheqës dhe fitimprurës. Ai i nënshtrohet faktorëve të shumtë globalë të cilët nxisin dhe lehtësojnë këtë aktivitet duke ndikuar Shqipërinë si pikë hyrjeje, tranziti dhe daljeje. Dhënia e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, në thelb është një krim fizik ndërkufitar, por që është e lidhur ngushtë me zhvillimet digjitale dhe teknologjike, siç është mbështetja në platformat *online* për marketing, rekrutim, komunikim dhe transferime parash, si edhe keqpërdorimi i aplikacioneve *online* si hartimi i rrugëve për të organizuar udhëtime për migrantët e parregullt. Trafikimi i njerëzve përbën një **kërcënim të vazhdueshëm** për sigurinë kufitare, rendin publik dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke u zhvilluar kryesisht përmes rrjeteve të organizuara kriminale që shfrytëzojnë flukset migratore, paqëndrueshmërinë ekonomike dhe

konfliktet rajonale. **Evoluimi** i fenomenit në të ardhmen pritet të lidhet me rritjen e përdorimit të teknologjisë dhe platformave *online* për rekrutimin, koordinimin dhe pagesat, si dhe me zhvendosjen e rrugëve të kontrabandimit në varësi të presionit ligjzbatues dhe zhvillimeve gjeopolitike në rajonin e Lindjes së Mesme.

Krimet mjedisore

Krimet mjedisore përbëjnë një **kërcënim në rritje** për sigurinë mjedisore, ekonomike dhe publike, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në degradimin e burimeve natyrore, humbjen e biodiversitetit dhe përkeqësimin e cilësisë së jetës së popullsisë. Veprimtari si ndotja e ajrit dhe ujërave, prerja e paligjshme e pyjeve, dëmtimi i habitateve të mbrojtura apo menaxhimi i paligjshëm i mbetjeve të rrezikshme shkaktojnë degradim afatgjatë të ekosistemeve dhe rrisin rrezikun për shëndetin publik. Krimet mjedisore po konsiderohen gjithnjë e më shumë si fushë me rrezik të lartë, sepse ato kombinojnë fitime të mëdha me rrezik penal relativisht të ulët. Gjithashtu, shfaqin rrezik të lartë jo vetëm për dëmin e menjëhershëm që shkaktojnë, por edhe për ndikimin të zgjatur në kohë. **Evoluimi** i krimeve mjedisore karakterizohet nga zgjerimi i formave të veprimit dhe rritja e kompleksitetit të tyre, të nxitura nga përfitimet ekonomike, urbanizimi, aktivitetet industriale dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore.

Përveç analizës së kërcënimit të raportit "Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë (SOCTA 2026)", vlerësimi i zbatimit të strategjisë së mëparshme ka shërbyer si bazë për zhvillimin e kësaj strategjie.

Bazuar në një analizë të hollësishme të të dhënave, përfshirë raportet e monitorimit të përgatitura nga Ministria e Punëve të Brendshme, evidencat dhe të dhënat nga një spektër i gjerë i burimeve institucionale dhe ndërkombëtare, vlerësimi i kërcënimit shërben si bazë për një kornizë strategjike më të fokusuar dhe të orientuar drejt rezultateve që kontribuon në adresimin e boshllëqeve dhe mangësive të identifikuara. Vlerësimi i kërcënimit nënvizon natyrën gjithnjë e më transnacionale dhe teknologjikisht të sofistikuar të këtyre kërcënimeve të krimit të organizuar, duke kërkuar përgjigje politike të forta dhe të përshtatshme.

Masat e zbatimit më vete nuk janë të mjaftueshme për t'iu kundërvënë efektivisht infiltrimit ekonomik nga krimi i organizuar. Një përgjigje gjithëpërfshirëse kërkon një theks më të fortë në **kornizat parandaluese**, që synojnë reduktimin e cenueshmërive përpara se aktiviteti kriminal të materializohet. Kjo përfshin **mekanizma të fortë administrativë dhe rregullatorë**, mbikëqyrje efektive të bazuar në vlerësim rreziku dhe detyrime të forcuara të kujdesit të duhur në sektorët me rrezik të lartë, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe trajtimin e këtyre kërcënimeve. Mjetet parandaluese si transparenca e pronarit përfitues, sistemet e zbulimit të hershëm dhe monitorimi i përmirësuar i flukseve financiare, luajnë rol përcaktues në identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve në një fazë të hershme.

Në të njëjtën kohë, këto masa parandaluese duhet të plotësohen nga ndërprerja efektive financiare e krimit, përfshirë gjurmimin, sekuestrimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve, për të siguruar që rrjetet kriminale jo vetëm të zbulohen herët, por edhe të privohen nga fuqia e tyre ekonomike. Së bashku, parandalimi dhe zbatimi, formojnë një qasje koherente dhe reciprokisht përforcuese për trajtimin e infiltrimit të krimit të organizuar.

Të dhënat nga autoritetet ligjzbatuese kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë tregojnë se grupet shqiptare të krimit të organizuar kanë evoluar në rrjete transnacionale shumë fleksibël dhe të afta për t'u përshtatur, me lidhje të forta logjistike, financiare dhe me bazë diasporike në të gjithë Evropën. Këto rrjete luajnë një rol të rëndësishëm në tregjet kriminale evropiane, veçanërisht në operacionet e trafikimit të drogës që lidhin Amerikën Latine me Evropën përmes pikave kryesore të hyrjes detare dhe korridoreve të shpërndarjes tokësore. Vlerësimet e kryera me metoda që kombinojnë modelet e bazuara në sekuestrime dhe ato të bazuara në konsum, tregon se grupet shqiptare të krimit të organizuar janë të integruara ndjeshëm në tregjet evropiane të drogës.

Të dhënat operacionale nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) konfirmojnë se hetimet e krimit të organizuar mbeten strukturalisht të rëndësishme dhe gjithnjë e më komplekse. Në

vitin 2025 janë regjistruar 74 çështje të krimit të organizuar. Gjithsej, 261 çështje kanë qenë nën hetim, ndërsa 185 persona janë hetuar dhe 183 persona janë dërguar në gjykatë.

Pavarësisht reduktimit të çështjeve të reja të regjistruara krahasuar me vitin e mëparshëm, numri i individëve të përfshirë në hetime u rrit, duke treguar një zhvendosje drejt synimit të rrjeteve më të mëdha dhe më komplekse kriminale.

Të dhënat nga Prokuroria e Përgjithshme (2021–2024) demonstrojnë më tej shkallën e aktivitetit kriminal të organizuar dhe përdorimin në rritje të teknikave proaktive të hetimit. Në vitin 2024 janë nisur 155 procedime penale, janë zhvilluar 405 hetime proaktive dhe janë regjistruar 354 arrestime ose ndalime. Për sa i përket **trafikimit të lëndëve narkotike**, me përjashtim të *kanabisit,* ku Shqipëria është vendi i origjinës, vendi ynë shfaqet si vend transiti në kategoritë e tjera të lëndëve narkotike, si heroina dhe kokaina. Sasitë e lëndëve narkotike të destinuara për tregun e brendshëm janë të vogla dhe shumica kalohet transit përmes territorit shqiptar, me destinacion vendet e BE-së. Vitet e fundit është zgjeruar aktiviteti i trafikimit të kokainës, e prodhuar në vendet e Amerikës së Jugut (Kolumbi, Ekuador dhe Brazil), e transportuar me rruga detare në Portin e Durrësit dhe duke vazhduar më pas drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Grupet kriminale shqiptare vazhdojnë të jenë kryesisht aktive në trafikimin e kokainës dhe kanabisit. Këto grupe janë aktive në disa shtete të Bashkimit Evropian (BE), kryesisht në Itali, Spanjë, Belgjikë, Holandë, Francë, Gjermani, si dhe në vende të tjera si Norvegji, Zvicër dhe Mbretëria e Bashkuar (MB). Këto konstatime përputhen edhe me konstatimet e raportit të Europolit për vitin 2024. Siç theksohet në raportin vjetor të SPAK-ut të vitit 2023, grupet kriminale shqiptare kanë arritur tashmë të sigurojnë blerjen e kokainës në vendet e prodhimit në Amerikën Latine. Kokaina porositet kryesisht në sasi të konsiderueshme në Bolivi, Meksikë, Peru, Ekuador dhe Paraguai. Shtetas shqiptarë, pjesëtarë të grupeve kriminale shqiptare, që banojnë në Brazil, Paraguai, Ekuador dhe Surinam, në disa raste në role drejtuese brenda grupit kriminal ose në raste të tjera në role dytësore (kryesisht koordinuese), ndjekin të gjithë procesin e transferimit të ngarkesës nga vendi i origjinës deri në destinacion.

Këta tregues pasqyrojnë një fokus të rritur institucional në goditjen e rrjeteve të strukturuara kriminale në vend të adresimit të akteve kriminale të izoluara.

Të dhënat e inteligjencës financiare evidentojnë përmasën dhe natyrën sistemike të rreziqeve që lidhen me krimin financiar dhe pastrimin e produkteve të veprës penale. Gjatë periudhës 2019–2025, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) ka referuar pranë autoriteteve ligjzbatuese gjithsej 1,911 raste të dyshuara për veprimtari financiare të paligjshme. Nga këto, 307 raste janë dërguar për ndjekje dhe vlerësim pranë prokurorive, 252 raste Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndërsa 1,352 raste janë referuar pranë Policisë së Shtetit për veprime të mëtejshme operative dhe hetimore.

Treguesit e rikuperimit të aseteve ilustrojnë më tej shkallën financiare të krimit të organizuar. Në vitin 2025, afërsisht **45.4 milionë euro** në asete kriminale u sekuestruan ose konfiskuan, përfshirë **12.4 milionë euro në asete kriptovalutash**.

Të dhënat nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) tregojnë se menaxhimi i aseteve është bërë një komponent gjithnjë e më i rëndësishëm i përgjigjes së Shqipërisë ndaj krimit të organizuar.

Megjithatë, sfidat strukturore mbeten, përfshirë përgjegjësitë e fragmentuara institucionale, kostot e mirëmbajtjes së aseteve, kufizimet e regjistrimit ligjor dhe kapacitetin e kufizuar për të menaxhuar asete komplekse si bizneset dhe instrumentet financiare digjitale.

Në tërësi, këta tregues konfirmojnë se krimi i organizuar që prek Shqipërinë vepron si pjesë e një ekosistemi më të gjerë kriminal transnacional, duke kombinuar rrjetet e trafikimit të drogës, infrastrukturat financiare, rreziqet e korrupsionit dhe mekanizmat komplekse të pastrimit të parave.

Analiza identifikon disa tregje kriminale që paraqesin **kërcënimet më të rëndësishme** për Shqipërinë dhe partnerët e saj ndërkombëtarë.

Grupet e strukturuara kriminale përfaqësojnë kornizën organizative bazë të krimit të organizuar dhe përbëjnë **54% të rasteve të krimit të rëndë të organizuar** në profilin e rrezikut të SPAK-ut të vitit 2025.

Këto grupe veprojnë përmes strukturave fleksibël dhe shpesh transnacionale, duke përfshirë qelizat e udhëheqjes dhe koordinimit, rrjetet e menaxhimit financiar dhe mbështetje logjistike. Në vitin 2025, SPAK-u mori pjesë në 6 Skuadra të reja të Përbashkëta Hetimore dhe mbajti 26 të tilla aktive, duke nxjerrë në pah dimensionin ndërkombëtar të këtyre rrjeteve.

Krimi financiar dhe ekonomik përbën një kërcënim qendror dhe në evoluim për sistemin financiar të Shqipërisë, integritetin ekonomik dhe sundimin e ligjit. Ndërsa **pastrimi i parave** mbetet një komponent kyç, ai është pjesë e një spektri më të gjerë aktivitetesh kriminale që përfshin evazionin tatimor, mashtrimin dhe korrupsionin, keqpërdorimin e strukturave të bizneseve dhe flukset e paligjshme financiare të lidhura me krimin e organizuar. Këto aktivitete janë të ndërlidhura ngushtë dhe së bashku mbajnë rrjetet kriminale, duke u mundësuar atyre të infiltrohen në ekonominë e ligjshme, të shtrembërojnë konkurrencën e tregut dhe të minojnë institucionet publike. Skemat e sofistikuara të krimit financiar shfrytëzojnë cenueshmëritë në sektorët formalë dhe joformalë, me rrezik të veçantë të identifikuar në sektorin e patundshmërive, ndërtimit, turizmit, dhe shërbimeve telematike. Këta sektorë shpesh shërbejnë si kanale për integrimin e fondeve të paligjshme në ekonominë e ligjshme. Tipologjitë e reja demonstrojnë kompleksitet në rritje, përfshirë shtresimin e fondeve përmes sistemit bankar, transaksioneve ndërkufitare, kontrabandës së parave kesh, pastrimit të parave të bazuar në tregti dhe investimeve në asete me vlerë të lartë. Përdorimi i kompanive guaskë, aktiviteteve fiktive të biznesit dhe rregullimeve ligjore të dizajnuara për të fshehur pronësinë përfituese dhe origjinën e të ardhurave, ndërlikon më tej përpjekjet e zbulimit dhe zbatimit. Në periudhën 2019-2025 AIF ka nxjerrë 52 urdhra të përkohshëm bllokimi në një vlerë prej afërsisht 26 milionë eurosh, prej të cilave mesatarisht 91% janë sekuestruar me vendim të Prokurorisë apo Gjykatës. SPAK-u regjistroi 32 procedime për pastrim parash në vitin 2025, duke konfirmuar rolin qendror të krimit financiar.

Sektori i shërbimeve telematike, përfshirë *call center*-at, është shfaqur gjithashtu si një kanal i përdorur për aktivitetet e pastrimit, shpesh me elemente ndërkombëtare të destinuara për të penguar gjurmimin financiar. Përfshirja e profesioneve jofinanciare, si noterët dhe ndërmjetësit e, pasurive të paluajtshme, shton më tej shtresa kompleksiteti. Paralelisht, në nivel ndërkombëtar kriptovalutat dhe asetet e tjera virtuale, po përdoren gjithnjë e më shumë për të lehtësuar transaksionet anonime ose të vështira për t'u gjurmuar. Megjithatë, referuar Vlerësimit Kombëtar të Riskut 2023 për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, por edhe në analiza risku të mëvonshme (2025) ka rezultuar se përdorimi i kriptovalutave në pastrimin e parave në Shqipëri mbetet në nivele ende minimale krahasuar me monedhat FIAT, si në numër rastesh, ashtu edhe në vlera të përdorura.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi publik-privat luan një rol kritik në parandalimin dhe zbulimin e krimit financiar dhe ekonomik. Një zhvillim pozitiv është ngritja dhe funksionimi i Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës (GTNP) ku nën koordinimin e AIF realizohen takime periodike. GTNP luan një rol të rëndësishëm në koordinimin e politikave, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. GTNP ka si anëtar përfaqësues nga organe publike si Ministria e Financave, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Shërbimi Informativ i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Shtetit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ILDKPKI, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti i Mbikëqyrjes të Lojërave të Fatit, Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe përfaqësues të sektorit privat si Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dhoma Shqiptare e Avokatisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të

Pasurive të Paluajtshme (NAREA), Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Shoqata e Agjencive të Këmbimit Valutor (AFEA), Shoqata e Ndërtuesve dhe Instituti për Demokraci dhe ndërmjetësim (IDM) etj.

Njëkohësisht, korrupsioni mbetet një mundësues i vazhdueshëm dhe një formë e veçantë e krimit të organizuar në vetvete, duke minuar proceset e zbatimit të ligjit. Grupet kriminale shfrytëzojnë rregullisht dobësitë në administratën publike, duke përdorur marrëdhëniet e korruptuara për të lehtësuar aktivitetet e paligjshme dhe për t'i shmangur zbulimit. Këto dinamika u mundësojnë rrjeteve të paligjshme të lehtësojnë operacionet, t'i shmangin zbulimit dhe të sigurojnë pandëshkueshmëri.

Në vitin 2025, SPAK-u regjistroi 10 raste të korrupsionit të nivelit të lartë, 13 të pandehur, 30 zyrtarë të lartë nën hetim, 18 zyrtarë të dërguar në gjykatë.

1.Pozicioni strategjik gjeografik i Shqipërisë, në udhëkryqin e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian, e bën atë shumë të cenueshme ndaj **kalimit të paligjshëm të kufirit nga emigrantët dhe trafikimit të qenieve njerëzore**. Janë identifikuar dy forma kryesore: kalimi i paligjshëm i shtetasve shqiptarë që kërkojnë hyrje të paligjshme në Mbretërinë e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Kanada, dhe kalimi transit i shtetasve nga vendet e treta, veçanërisht nga Pakistani, Egjipti dhe Bangladeshi, drejt BE-së. Grupet e organizuara përdorin falsifikim të avancuar të dokumenteve, shfrytëzojnë sistemet e lejeve të punës dhe vizave, dhe përdorin metoda të sofistikuara pagese, përfshirë kriptovalutat, për të lehtësuar emigrimin e paligjshëm. Grupet e cenueshme dhe të margjinalizuara, si gratë, fëmijët dhe pakicat etnike, mbeten në mënyrë disproporcionale të prekur nga këto aktivitete kriminale. Aktualisht, janë identifikuar dy forma të trafikimit të qenieve njerëzore.

2. **Forma e parë e trafikimit** përfshin shtetas shqiptarë që synojnë të udhëtojnë në mënyrë të paligjshme drejt Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-së dhe Kanadasë. Grupet kriminale menaxhojnë të gjithë procesin, nga falsifikimi i dokumenteve të identifikimit të vendeve të BE-së deri tek organizimi i udhëtimit, akomodimit dhe orientimit të personave. Vihet re përdorimi i teknologjive të avancuara për falsifikimin e dokumenteve, si dhe i metodave më të sofistikuara të pagesës, përfshirë kriptovalutat.

3.**Forma e dytë** karakterizohet nga trafikimi i shtetasve që vijnë nga vendet e treta që përdorin Shqipërinë si pikë transiti, duke u larguar më pas në mënyrë të paligjshme drejt vendeve të BE-së. Të dhënat tregojnë se pas një rënieje të ndjeshme të numrit të imigrantëve të parregullt në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, gjatë vitit 2025 është regjistruar një rikthim i trendit në rritje. Numri i imigrantëve të kapur u rrit me 25% në vitin 2025 dhe kjo tendencë vijon edhe gjatë vitit 2026, ku të dhënat e gjashtëmujorit të parë tregojnë një shtim të konsiderueshëm të flukseve migratore të parregullta drejt territorit shqiptar.

4.Analiza e të dhënave për vitin 2025 mbi shtetasit e vendeve të treta të identifikuar si viktima të trafikimit të qenieve njerëzore tregon një total prej 79 rastesh, nga të cilat shumica dërrmuese janë femra. Nga këto, 76 viktima janë gra dhe vetëm 3 janë meshkuj, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e rasteve paraqiten si viktima të dyshuara. Të dhënat evidentojnë një dominim të qartë të trafikimit të grave, kryesisht për qëllime shfrytëzimi seksual ose ekonomik, duke reflektuar tendencat ndërkombëtare të trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, shpërndarja gjeografike e viktimave tregon se rrjetet kriminale veprojnë në mënyrë të organizuar dhe ndërkontinentale, duke përfshirë vende nga Azia, Amerika Latine, Afrika dhe Evropa Lindore.

5.Ndërkohë referuar të dhënave të administruara për vitin 2024 janë identifikuar dhe referuar gjithsej 178 viktima/viktima të mundshme trafikimi.

Ky fenomen trajtohet si prioritet i dedikuar në **Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2026–2030 dhe Planit të Veprimit të saj**, aktualisht në proces hartimi. Brenda kësaj kornize, kjo strategji fokusohet kryesisht në dimensionin e krimit të organizuar të kontrabandës dhe trafikimit të migrantëve, përfshirë përfshirjen e rrjeteve të strukturuara kriminale, lehtësimin ndërkufitar dhe flukset financiare.

Krimi mjedisor është shfaqur si një prioritet tematik i rëndësishëm brenda peizazhit të krimit të organizuar në Shqipëri, me ndikime në rritje mbi burimet natyrore, shëndetin publik, integritetin ekologjik dhe qëndrueshmërinë

ekonomike të vendit. Të dhënat institucionale tregojnë një rritje të veprave penale mjedisore gjatë periudhës 2023–2025, duke reflektuar rëndësinë në rritje të këtij fenomeni në agjendën e zbatimit të ligjit. Krimi mjedisor trajtohet si një formë prioritare e krimit të organizuar, në përputhje me kërkesat e Direktivës (BE) 2024/1203, përmes një qasjeje të integruar që mbulon parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale, sanksionimin dhe konfiskimin e përfitimeve të paligjshme.

Krimi mjedisor mbetet një fushë me kompleksitet të shtuar, për shkak të natyrës së tij ndërsektoriale, mundësive për përfitime të larta dhe nevojës për koordinim të ngushtë ndërmjet institucioneve rregullatore dhe ligjzbatuese. Në këtë kuadër, është vënë re rëndësia e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit institucional dhe e rritjes së kapaciteteve hetimore dhe analitike në trajtimin e këtyre rasteve.

Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe territorit. Këto përfshijnë rishikimin dhe qartësimin e kompetencave të inspektorateve, me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe reduktimin e mbivendosjeve funksionale, si dhe avancimin e proceseve të digjitalizimit të inspektimeve përmes platformës *e-Inspektimi*.

Zbatimi i teknologjive të avancuara, përfshirë monitorimin në kohë reale dhe përdorimin e mjeteve digjitale për dokumentimin e inspektimeve, synon të rrisë transparencën, efikasitetin dhe gjurmueshmërinë e proceseve administrative. Në këtë kuadër, është miratuar edhe një kuadër rregullator për metodologjinë e përcaktimit të masave administrative, i cili synon të forcojë qasjen e bazuar në rrezik dhe të sigurojë proporcionalitet në vendimmarrje.

Gjithashtu, janë ndërmarrë ndryshime ligjore në fushën penale dhe të planifikimit territorial, me fokus në forcimin e parandalimit dhe rritjen e efektivitetit të reagimit institucional ndaj veprave që dëmtojnë mjedisin dhe territorin, përfshirë zjarrvënien, ndërtimet e paligjshme dhe shkeljet në përdorimin e tokës. Këto ndryshime synojnë gjithashtu rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe forcimin e integritetit në ushtrimin e funksioneve publike.

Në aspektin operacional, është rritur bashkëpunimi ndërmjet strukturave inspektuese në nivel qendror dhe vendor, si dhe është përmirësuar përdorimi i sistemeve digjitale për monitorim dhe kontroll, duke mundësuar një ndjekje më të efektshme të zbatimit të lejeve dhe identifikimin në kohë të shkeljeve të mundshme.

Në tërësi, këto zhvillime tregojnë një proces të vazhdueshëm të modernizimit të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me synim forcimin gradual të kapaciteteve parandaluese dhe zbatuese. Në këtë kontekst, vijon të jetë me rëndësi konsolidimi i mëtejshëm i koordinimit ndërinstitucional dhe zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe hetimore, në funksion të rritjes së efektivitetit të përgjithshëm të sistemit.

Evoluimi i shpejtë i **krimit të mundësuar nga teknologjia kibernetike po riformëson mjedisin e kërcënimeve** në Shqipëri. Grupet kriminale të organizuara shfrytëzojnë përparimet teknologjike për të kryer mashtrime në shkallë të gjerë, vjedhje identiteti dhe skema financiare mashtruese, shpesh duke synuar viktima në juridiksione të shumta. Format e zakonshme të krimit kibernetik përfshijnë mashtrimin kompjuterik *(phishing, smishing),* kompromentimin e *email*-eve të biznesit dhe përdorimin e *deepfake*-ve të drejtuara nga IA. Në kuadër të ndërgjegjësimit, në faqen zyrtare të FIA-s është publikuar një udhëzues mbi sigurinë në epokën digjitale, i cili shpjegon konceptet e mashtrimit kompjuterik, metodat e zakonshme të mashtrimit kompjuterik, masat për mbrojtje dhe hapat që duhet ndjekur në rast se individi bie viktimë etj.

Grupet kriminale themelojnë kompani që operojnë platforma mashtruese investimi, duke përdorur *call centre* në Shqipëri dhe vendet fqinje për të mashtruar qytetarë, kryesisht nga shtetet anëtare të BE-së. Këto skema kanë rezultuar në miliona euro humbje dhe nxjerrin në pah rolin në rritje të Shqipërisë si qendër për aktivitetin kriminal të mundësuar nga teknologjia kibernetike.

Në të njëjtën kohë, **shfrytëzimi seksual i fëmijëve në internet** është një kërcënim gjithnjë e më serioz dhe në evoluim. Shkelësit përdorin platforma të enkriptuara, mediat sociale dhe rrjetin e errët për të prodhuar, shpërndarë dhe aksesuar materiale të abuzimit seksual të fëmijëve, si dhe për të joshur dhe shfrytëzuar të miturit.

Natyra transnacionale e këtyre veprave penale, e kombinuar me përdorimin e teknologjive që rrisin anonimitetin, paraqet sfida të rëndësishme për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale. Adresimi i shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet kërkon kapacitete të forcuara të specializuara hetimore, bashkëpunim të rritur ndërkombëtar dhe një qasje të orientuar nga viktima të harmonizuar me standardet e BE-së dhe ndërkombëtare. **Konvergjenca e operacioneve transnacionale dhe novacionit të shpejtë teknologjik** u mundëson grupeve kriminale shqiptare të veprojnë në juridiksione të shumta me një shkathtësi dhe anonimitet të paprecedentë, duke sfiduar qasjet tradicionale të zbatimit të ligjit.

Pavarësisht mjedisit kompleks dhe në evolucion të kërcënimit, Shqipëria ka arritur progres substancial në forcimin e përgjigjes ndaj krimit të organizuar. Periudha 2021-2025 është karakterizuar nga reforma institucionale, përparime ligjore, ngritje kapacitetesh dhe bashkëpunim i rritur ndërkombëtar.

Konsolidimi i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka qenë thelbësor për forcimin institucional, duke mundësuar hetime komplekse dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar. Ngritja dhe funksionimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në bazë të Ligjit nr. 44/2025, ka shtruar themelet që Shqipëria të përmirësojë gjurmimin dhe kapacitetet e konfiskimit, si edhe të harmonizojë praktikën kombëtare me standardet e BE-së. Megjithatë, zbatimi efektiv i mekanizmave të rikuperimit të aseteve dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare paralele mbetet i pabarabartë dhe kërkon konsolidim të mëtejshëm. Teksa hetimet financiare po integrohen gjithnjë e më shumë në çështjet e krimit të organizuar, zbatimi konsistent dhe proaktiv i tyre në të gjitha çështjet relevante është ende në zhvillim. Nismat e digjitalizimit kanë kontribuuar në modernizimin e doganave, menaxhimit të kufirit dhe sistemeve policore, duke përmirësuar efikasitetin dhe transparencën; megjithatë, mbeten sfida në garantimin e ndërveprueshmërisë së plotë, integrimin e të dhënave dhe përdorimin operacional efektiv.

Shqipëria ka ndërmarrë **reforma të rëndësishme ligjore** për të forcuar kornizën legjislative kundër krimit të organizuar dhe veprave penale të lidhura. Ndryshimet në ligjin nr. 7975 për lëndët narkotike dhe substancat psikotrope, të miratuara në fillim të vitit 2024, kanë modernizuar tabelat e klasifikimit dhe kanë lehtësuar përdorimin e kontrolluar të kanabisit për qëllime industriale dhe mjekësore. Kornizat ligjore dhe strategjike që adresojnë pastrimin e parave (PP), kundër financimit të terrorizmit (FT) dhe sigurinë kibernetike janë përditësuar, duke mundësuar zhvillimin e një infrastrukture të fortë institucionale dhe duke mbështetur hetimet e bazuara në inteligjencë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është përmirësuar dhe forcuar përmes pjesëmarrjes aktive të Shqipërisë në skuadrat e përbashkëta hetimore (SPH) dhe koordinimit të saj operacional të forcuar me Shtetet Anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së, veçanërisht Europolin dhe Eurojustin, dhe partneritetit operacional me FRONTEX-in. Shqipëria është shteti i parë joanëtar i Bashkimit Evropian që ka vendosur njësi të FRONTEX-it në territorin e vet. Nisja e Operacionit të Përbashkët me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare, FRONTEX, që nga maji 2019, në kufirin juglindor të Shqipërisë, ka pasur ndikim pozitiv në menaxhimin e migracionit të paligjshëm në vendin tonë. Një nga rezultatet e para pozitive nga ky operacion ka qenë forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe logjistike për monitorimin e zonës kufitare. Si rezultat, identifikimi i migrantëve të paligjshëm në pikat e hyrjes përgjatë kufirit ka shënuar një rritje të rëndësishme, nga 40% e të gjitha rasteve në 2019 në 90-95% në 2023.

Në vijim të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, në kuadër të procesit të integrimit evropian, me urdhrin nr. 127, datë 26.07.2024, u krijua Njësia Kombëtare e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për Droga Sintetike dhe Substanca të Reja Psikoaktive, e cila gjatë vitit 2025 u bë plotësisht funksionale. Bashkëpunimi me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Drogat (EUDA) ka mundësuar shkëmbim të vazhdueshëm informacioni, përmes të cilit janë përcjellë 43 alarme për substanca të reja psikoaktive dhe janë identifikuar dy substanca të reja në territorin e vendit, njëra prej të cilave është raportuar në rrjetin evropian të paralajmërimit të hershëm. Ky bashkëpunim është shoqëruar

gjithashtu me forcimin e kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve, takimeve teknike dhe shkëmbimit të praktikave më të mira evropiane për vlerësimin e rrezikut dhe monitorimin e këtyre substancave, si dhe me avancimin e koordinimit ndërinstitucional në nivel kombëtar për krijimin e një sistemi të integruar të paralajmërimit të hershëm.

Bashkëpunimi është fokusuar gjithnjë e më shumë në trajtimin e krimit të rëndë dhe të organizuar përmes hetimeve të koordinuara, shkëmbimit të inteligjencës dhe veprimeve operacionale të përbashkëta. Shqipëria ka vazhduar gjithashtu të thellojë bashkëpunimin në fushën e gjurmimit dhe rikuperimit të aseteve, përfshirë përmes ndërveprimit me strukturat përkatëse në Shtetet Anëtare të BE-së, duke mbështetur hetime ndërkufitare më efektive dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Pjesëmarrja në mekanizmat dhe rrjetet ndërkombëtare ka mbështetur më tej harmonizimin me standardet e BE-së dhe ka lehtësuar bashkëpunimin operacional në fushat prioritare të krimit.

Partneriteti operacional me FRONTEX ose operacionalizimi i Njësisë së Informacionit të Pasagjerëve kanë kontribuar më tej në forcimin e menaxhimit të kufijve dhe bashkëpunimit të lidhur me migrimin në përputhje me standardet e BE-së. Megjithatë, strategjia vendos theks specifik në bashkëpunimin ndërkombëtar që synon rrjetet kriminale të organizuara të përfshira në kalimin e paligjshëm të kufirit dhe trafikimin e emigrantëve. Mekanizmat e paralajmërimit të hershëm dhe shkëmbimit të informacionit, përfshirë Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm për substancat e reja psikoaktive, demonstrojnë më tej angazhimin e Shqipërisë për t'u harmonizuar me direktivat dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Evoluimi i shpejtë i krimit të mundësuar nga teknologjia kibernetike thekson **domosdoshmërinë për të mbështetur kapacitetet digjitale dhe kibernetike**. Zhvillimi i kriminalistikë së avancuar digjitale, përmirësimi i gjurmimit të aseteve kripto dhe forcimi i inteligjencës kibernetike janë jetike për të mbajtur ritmin në përballje me taktikat gjithnjë e më të sofistikuara kriminale. Strategjia thekson nevojën për të forcuar përgjigjet institucionale dhe ligjore, përfshirë përmirësimin e kriminalistikës digjitale, zhvillimin e kapaciteteve të inteligjencës kibernetike dhe përditësimin e kornizave ligjore për të adresuar kërcënimet e reja. Megjithatë, efektiviteti i këtyre masave varet në masë të konsiderueshme nga forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional dhe brenda vetë institucioneve të përfshira, fusha në të cilat nevojiten ende përmirësime të mëtejshme për të rritur eficiencën e përgjigjes së Shqipërisë ndaj krimit të organizuar.

Ndërsa bashkëpunimi është veçanërisht përcaktues në adresimin e krimit të mundësuar nga teknologjia kibernetike për shkak të natyrës së tij ndërkufitare dhe teknike, **kjo sfidë shtrihet në të gjitha fushat e krimit të organizuar**, përfshirë hetimet financiare, trafikimin e drogës, korrupsionin, krimin mjedisor dhe trafikimin e emigrantëve.

Në nivel ndërinstitucional, ekzistojnë mundësi të mëtejshme për forcimin e shkëmbimit në kohë dhe në mënyrë sistematike të inteligjencës operacionale dhe strategjike ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave të koordinimit dhe i platformave të integruara do të kontribuonte në rritjen e efikasitetit të shkëmbimit elektronik të informacionit dhe në avancimin e analizave të përbashkëta ndërinstitucionale.

Në nivel institucional, ka potencial për përmirësimin e koordinimit ndërmjet strukturave operacionale, analitike dhe strategjike. Fuqizimi i flukseve të informacionit dhe promovimi i komunikimit horizontal dhe vertikal do të mbështesnin reagime më të shpejta dhe ndërhyrje më proaktive.

Më tej, konsolidimi i kulturës së bashkëpunimit, rritja e besimit institucional dhe zhvillimi i protokolleve të standardizuara për vendimmarrje të përbashkët do të krijonin kushte më të favorshme për operacione të udhëhequra nga inteligjenca dhe veprime të koordinuara ligjzbatuese.

Në këtë kuadër, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional përmes zhvillimit të sistemeve të integruara të informacionit, përmirësimit të shkëmbimit të të dhënave, ngritjes së kapaciteteve të përbashkëta analitike dhe konsolidimit të mekanizmave të koordinimit, me qëllim rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar.

Gjithashtu, vazhdimi i përpjekjeve për forcimin e sistemeve të integritetit, veçanërisht në sektorët me ekspozim më të lartë ndaj rrezikut, si menaxhimi i kufijve, licencimi dhe prokurimi publik, do të kontribuojë në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besimit në administratën publike.

Mbi bazën e progresit të arritur, ekzistojnë mundësi të mëtejshme për forcimin e përpjekjeve në fushën e rikuperimit dhe menaxhimit të aseteve, përmes rritjes së profesionalizmit, përmirësimit të ndërveprueshmërisë ndërinstitucionale dhe konsolidimit të koordinimit operacional, me qëllim maksimizimin e efektivitetit dhe ndikimit të tyre.

Parandalimi në nivel komunitar paraqet potencial të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejshëm. Rritja e fokusit në masat parandaluese në nivel vendor do të kontribuojë në reduktimin e faktorëve që favorizojnë përfshirjen në veprimtari kriminale dhe në forcimin e rezistencës së komuniteteve ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar.

Sektori bankar vijon të luajë një rol qendror në sistemin financiar dhe, për rrjedhojë, mbetet një nga kanalet kryesore përmes të cilit identifikohen dhe monitorohen flukset financiare të lidhura me pastrimin e parave. Ky pozicion lidhet me natyrën e veprimtarisë bankare dhe gamën e gjerë të shërbimeve të ofruara, me rolin dominues të sektorit bankar në tregun financiar, si dhe me volumin e lartë të klientëve dhe transaksioneve, përfshirë transfertat ndërkufitare. Në këtë kontekst, sektori bankar përfaqëson një partner kyç në forcimin e mekanizmave të parandalimit, zbulimit dhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta.

Ndërsa Shqipëria ka konsoliduar më tej infrastrukturën e saj në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë (PPP/FT/FADM), duke mundësuar rritjen e kapaciteteve për zbulimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta, veçanërisht nga sektori bankar, ekzistojnë mundësi për zgjerimin e mëtejshëm të angazhimit të të gjithë aktorëve të përfshirë. Në veçanti, forcimi i pjesëmarrjes së profesioneve të caktuara jofinanciare, si avokatët, kontabilistët dhe audituesit ligjorë, do të kontribuonte në rritjen e efektivitetit të masave parandaluese dhe në fuqizimin e integritetit të sistemit kombëtar të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave.

Raportet e BE-së dhe të organizmave të tjerë, si dhe Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024 - 2030, theksojnë nevojën për të kaluar drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse ndaj krimit financiar dhe ekonomik, të bazuar në rrezik dhe në bashkëpunimin më të fortë publik-privat, transparencën e zgjeruar të pronësisë përfituese, integrimin e përmirësuar të të dhënave dhe përdorimin sistematik të inteligjencës financiare në hetime. Adresimi i krimit financiar dhe ekonomik, për këtë arsye, kërkon një qasje të integruar që kombinon mbikëqyrjen parandaluese, inteligjencën financiare, zbatimin rregullator dhe hetimin penal, duke siguruar që flukset e paligjshme financiare të zbulohen herët dhe që themelet ekonomike të krimit të organizuar të ndërpriten efektivisht.

Në mënyrë të përmbledhur, vlerësimi i kërcënimeve tregon se mjedisi kriminal në Shqipëri shënohet nga rrjete të organizatave kriminale që përshtaten, transnacionale dhe teknologjikisht të avancuara. Arritjet e strategjisë 2021 - 2025 demonstrojnë kapacitetin e vendit për reformë dhe harmonizim me normat ndërkombëtare, megjithatë, sfidat sistemike të vazhdueshme mbeten. Në këtë sfond strategjia prioritizon:

- **Forcimin e mjeteve administrative dhe rregullatore për të plotësuar zbatimin.** Kjo përfshin forcimin e mekanizmave të fortë mbikëqyrës dhe kornizave rregullatore për të mbyllur boshllëqet që krimi i organizuar mund të shfrytëzojë. Duke përforcuar këto struktura, krahas zbatimit tradicional, autoritetet mund të sigurojnë një përgjigje më holistike dhe efektive ndaj aktivitetit kriminal.

- **Konsolidimin e ndërprerjes financiare, rikuperimin e aseteve dhe transparencën e pronarit përfitues**. Çelësi për goditjen e rrjeteve kriminale është prioritizimi i hetimeve financiare, gjurmimi i unifikuar i aseteve. Kjo qasje pengon flukset e paligjshme financiare dhe fshehjen e aseteve pas strukturave komplekse të biznesit.

- **Përmirësimin e kapaciteteve digjitale dhe kibernetike**. Zhvillimi i aftësive të avancuara kriminalistike digjitale dhe inteligjencës

kibernetike është thelbësor për të luftuar kundër krimeve gjithnjë e më të sofistikuara, të mundësuara nga teknologjia kibernetike, si dhe për të mundësuar zbulim, hetim dhe përgjigje të shpejtë ndaj kërcënimeve digjitale.

- **Përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional, integrimit të të dhënave dhe profesionalizimit**. Përmirësimi i bashkëpunimit midis agjencive dhe integrimi i sistemeve të tyre të të dhënave do të promovojë operacione më efektive të udhëhequra nga inteligjenca. Zhvillimi profesional dhe trajnimi në të gjitha institucionet janë gjithashtu thelbësore për ruajtjen e standardeve të larta dhe efektivitetit operacional.

- **Përforcimin e sistemeve të integritetit, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë**. Zbatimi i kontrolleve të rrepta dhe rritja e mbikëqyrjes në fusha si menaxhimi i kufijve, dhe prokurimi ndihmon në parandalimin e korrupsionit dhe ruan besueshmërinë e institucioneve publike.

- **Zgjerimin e masave të parandalimit dhe rezistencës**. Fokusi në nismat në nivel komunitar dhe ndërhyrjet proaktive synojnë reduktimin e rekrutimit të personave në krimin e organizuar dhe forcimin e mbrojtjeve shoqërore kundër ndikimit kriminal.

- **Thellimin e bashkëpunimit ndër-kombëtar dhe pajtueshmërisë me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare**. Forcimi i partneriteteve ndërkufitare dhe harmonizimi me praktikat më të mira ndërkombëtare është jetësor për adresimin efektiv të krimit transnacional dhe mbështetjen e aspiratave të Shqipërisë për integrimin evropian.

Në raport progresin e Komisionit Evropian për vitin 2025, Bashkimi Evropian ka vlerësuar progresin e Shqipërisë nëpërmjet harmonizimit të kuadrit ligjor si dhe përparimit në ngritjen dhe zhvillimin e strukturave si Zyra e Rikuperimit të Aseteve (ARO), SPAK dhe BKH dhe rritjen e aksesit në bazat e të dhënave.

Gjithashtu, raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2024 konstaton se *"Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar duke forcuar kapacitetet e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke përmirësuar përdorimin e hetimeve paralele financiare dhe duke ndryshuar kornizën ligjore për substancat psikotrope."*

Në **raportin më të fundit të Europol SOCTA për vitin 2025**, për Evropën, theksohet se krimi i organizuar sot nuk kufizohet më vetëm në botën fizike, por është gjithnjë e më i pranishëm në hapësirën digjitale dhe po përshpejtohet nga zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të reja.

Masa 2.5.2: Miratimi një plani të detajuar për sistemimin e strukturës së Policisë Shkencore në ambientet e reja, përfshirë planifikimin e hapësirës, zonimin funksional të laboratorëve dhe zonave të provave, kërkesat e sigurisë, masat e sigurisë në punë, afatet kohore të zhvendosjes në faza dhe modalitetet e vazhdimësisë së punës, për të shmangur ndërprerjen e shërbimeve kriminalistike.

Masa 2.5.3: Zbatimi i standardeve minimale të cilësisë për hetimet në vendin e ngjarjes dhe për administrimin e provave nga vendi i ngjarjes deri në sallën e gjyqit, përfshirë procedurat standarde operacionale për sigurimin, dokumentimin, mbledhjen, paketimin, transportimin, ruajtjen, ekzaminimin dhe paraqitjen e provave, me qëllim garantimin e integritetit, gjurmueshmërisë dhe pranueshmërisë së provave.

Masa 2.5.4: Krijimi dhe sigurimi i funksionimit të bazave të të dhënave për administrimit të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", përfshirë duke përcaktuar qëllimet e ligjshme të përpunimit, kontrollet e aksesit, rregullat e ruajtjes, gjurmët e auditimit dhe garancitë e sigurisë së të dhënave për të mbrojtur të dhënat personale, ndërsa mundësohet krahasimi efektiv kriminalistik.

Masa 2.5.5: Rishikimi dhe përditësimi i programit fillestar dhe të vazhdueshëm të trajnimit për oficerët e Policisë Shkencore dhe personelin civil të Institutit të Policisë Shkencore, përfshirë vlerësimet e nevojave, përditësimin e kurrikulës, kërkesat e certifikimit/kompetencës dhe modulet praktike të harmonizuara me standardet ISO dhe metodat e reja kriminalistike.

Masa 2.5.6: Mundësimi i shkëmbimit me partnerët të të dhënave të automatizuara në fushën e të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, në bazë të dispozitave të Marrëveshjes PCC Prum, duke siguruar ndërveprueshmëri teknike, kanale të sigurta komunikimi, procedura të standardizuara të kërkimit dhe ndjekjes, si dhe pasjtueshmërinë me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave.

Masa 2.5.7: Arritja e akreditimit të shërbimeve të ofruara nga Instituti i Policisë Shkencore sipas standardeve ISO, i zbatuar në faza, duke prioritizuar disiplinat shkencore me ndikim të lartë, duke kryer auditimet e brendshme, duke adresuar mospërputhjet (identifikimi, dokumentimi, vlerësimi dhe korrigjimi i devijimeve nga standardet e cilësisë së vendosur) dhe duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.

Masa 2.5.8: Hartimi një plani të dedikuar për zbatimin e metodave novatore në shkencat kriminalistike në luftën kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale, përfshirë identifikimin e metodave prioritare, pajisjeve dhe trajnimit të kërkuar, procedurat e validimit dhe integrimin në flukset operacionale të punës.

Masa 2.5.9: Mbështetja dhe forcimi i kapaciteteve për procesin e menaxhimit të cilësisë në nivel rajonal të hetimit të vendngjarjes dhe në nivel qendror, përfshirë përmes procedurave të harmonizuara, mentorimit, kontrolleve të brendshme dhe rishikimeve periodike të cilësisë për të siguruar zbatim konsistent të standardeve në të gjithë vendin.

Masa 2.5.10: Ngritja dhe mirëmbajtja e një regjistri për inventarin e pajisjeve kriminalistike duke identifikuar sistematikisht nevojat për kalibrim, mirëmbajtje, rinovim ose zëvendësim të tyre, përfshirë duke vendosur afate, caktuar përgjegjësi dhe siguruar gjurmueshmërinë e ndërhyrjeve për të mbrojtur besueshmërinë e rezultateve kriminalistike.

Masa 2.5.11: Hartimi i një plani investimi për 1, 3 dhe 5 vjet për ofrimin e shërbimeve të policisë shkencore, përfshirë nevojat e prioritizuara të prokurimit dhe infrastrukturës, buxhetimin dhe burimet e financimit, kërkesat për burime njerëzore dhe trajnim, dhe pikat e referimit të lidhura me akreditimin e shërbimit dhe objektivat e cilësisë.

Masa 2.5.12: Ndërtimi i Serverit të Stacionit të Kontrollit në Distancë për të mundësuar krahasimin e drejtpërdrejtë të të dhënave daktiloskopike në sistemin AFIS Papillon të Institutit të Policisë Shkencore, duke siguruar ndërlidhje të sigurt, kapacitet të mjaftueshëm të serverit, integrim me flukset ekzistuese të punës dhe auditueshmëri të kërkimeve dhe përputhjeve.

Masa 2.5.13: Organizimi i trajnimeve dhe vlerësimeve periodike të kompetencave të ekspertëve të vendngjarjes, përfshirë vlerësimet praktike, proceset e certifikimit/ricertifikimit dhe ngritjen e kapaciteteve të shënjestruara për të garantuar zbatim konsistent të standardeve minimale të cilësisë dhe trajtim të duhur të provave.

Masa 2.5.14: Integrimi i IPSh në komunitetin ndërkombëtar të shkencave kriminalistike, përfshirë

përmes pjesëmarrjes në rrjete përkatëse, shkëmbime dhe aktivitete të krahasimit, me qëllim përshtatjen modeleve, praktikave dhe metodave novatore të përdorura nga vendet e zhvilluara për përfshirjen e tyre në politikat kombëtare të zhvillimit të shërbimit kriminalistik në Shqipëri.

Masa 2.5.15: Rishikimi dhe propozimi i ndryshimeve ligjore në lidhje me mbledhjen e mostrave të ADN-së nga të dyshuarit dhe të arrestuarit, përfshirë duke sqaruar bazën ligjore, garancitë procedurale, kërkesat e zinxhirit të ruajtjes, periudhat e ruajtjes dhe garancitë e mbrojtjes së të dhënave, me qëllim forcimin e efektivitetit hetimor dhe respektimin e të drejtave themelore.

Masa 2.5.16: Përditësimi i programeve të trajnimit me zhvillime të reja teknologjike, bazuar në nevojave të identifikuara dhe zhvillim trajnimeve për sigurimin dhe ekzaminimin e vendngjarjes, përfshirë modulet mbi pajisjet e reja, dokumentimin digjital, parandalimin e kontaminimit dhe integritetin e provave.

Masa 2.5.17: Rishikimi dhe përditësimi i programit fillestar dhe të vazhdueshëm të trajnimit për oficerët e policisë gjyqësore, përfshirë modulet mbi koordinimin efektiv me ekspertët kriminalistë, trajtimin dhe referimin e provave, kërkimin dhe interpretimin e ekspertizave dhe paraqitjen në sallën e gjyqit të konstatimeve kriminalistike.

Masa 2.5.18: Forcimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale për kryerjen e ekzaminimeve digjitale, përfshirë përmes personelit të specializuar, mjeteve moderne kriminalistike digjitale, metodologjive të standardizuara dhe trajnimit të vazhdueshëm për të mbështetur hetimet që përfshijnë pajisjet elektronike, provat *online* dhe gjurmët digjitale komplekse.

Masa 2.5.19: Hartimi dhe shpërndarja e një udhëzuesi që përditësohet çdo vit, mbi paketimin dhe ruajtjen e provave fizike, problematikat e afateve, si dhe rishikimi i strategjisë për çështjet kriminalistike dhe protokolleve të marrjes në dorëzim, me qëllim që të sigurohet trajtim konsistent i provave dhe forcim i pranueshmërisë dhe besueshmërisë së rezultateve kriminalistike.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.5.1

- Finalizimi dhe miratimi i projektvendimit për organizimin dhe funksionimin e IPSh-së, duke siguruar harmonizim me kërkesat ISO 17025 dhe modelet ndërkombëtare të qeverisjes kriminalistike.

- Hartimi i **një plan veprimi të detajuar për zbatim, që përcakton përgjegjësitë, afatet kohore, nevojat për burime dhe modalitetet e monitorimit për të udhëhequr procesin e reformës.**

Aktivitete për masën 2.5.2

· Përgatitja e planit të sistemimit gjithëpërfshirës që detajon zonën e laboratorit, zonat e trajtimit të provave, sistemet e sigurisë dhe kërkesat e sigurisë në punë për ambientet e reja të IPSh-së.

- Zbatimi i një kalendari për zhvendosjen me faza, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve kriminalistike, përfshirë rregullimet e kontingjencës për të shmangur ndërprerjen e shërbimit.

Aktivitete për masën 2.5.3

- Hartimi dhe zbatimi i procedurave standarde operacionale për sigurimin, dokumentimin, mbledhjen, paketimin, transportimin, ruajtjen dhe paraqitjen e provave nga vendngjarja deri në sallën e gjyqit.

- Kryeja e auditimeve periodike dhe vlerësime praktike për të siguruar zbatim konsistent të procedurave standarde operacionale dhe gjurmueshmëri të plotë të provave gjatë gjithë zinxhirit të ruajtjes.

Aktivitete për masën 2.5.4

- Instalimi dhe vënia në punë e bazës së të dhënave të ADN-së dhe gjurmëve të gishtave, me qëllime të qarta përpunimi, kontrolle aksesi, rregulla ruajtjeje dhe gjurmë auditimi, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Zbatimi i garancive të sigurisë së të dhënave dhe kontrolleve periodike të cilësisë, për të siguruar saktësinë, integritetin dhe përdorimin e ligjshëm të të dhënave kriminalistike.

Aktivitete për masën 2.5.5

- Kryerja e vlerësimeve të nevojave për trajnim dhe përditësimi i kurrikulave, me qëllim që të reflektohen standardet ISO, metodat e reja kriminalistike dhe teknologjitë e reja.

- Zbatimi i moduleve të trajnimit bazuar në certifikim dhe kompetencë, përfshirë ushtrime praktike laboratorike dhe vlerësime **të bazuara në skenarë.**

Aktivitete për masën 2.5.6

- Sigurimi i ndërveprueshmërisë teknike dhe kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin

e automatizuar të të dhënave të ADN-së dhe gjurmëve të gishtave me shtetet partnere, sipas Marrëveshjes PCC Prüm.

- Hartimi i procedurave të standardizuara për kërkimin, protokollet e ndjekjes dhe përputhshmërinë me garancitë e mbrojtjes së të dhënave, me qëllim që të sigurohet bashkëpunim kriminalistik ndërkufitar i ligjshëm dhe efikas.

Aktivitete për masën 2.5.7

- Prioritizimi i disiplinave kriminalistike me ndikim të lartë për akreditim fillestar dhe kryerja e auditimeve të brendshme për identifikimin dhe korrigjimin e mospërputhjeve.

- Zbatimi i proceseve të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, **përfshirë përditësimet e dokumentacionit, veprimet korrigjuese dhe rishikimet periodike të menaxhimit.**

Aktivitete për masën 2.5.8

- Identifikimi i metodave kriminalistike prioritare novatore (p.sh., kriminalistika digjitale, ADN e shpejtë, balistika e avancuar) dhe përcaktimi i nevojave për pajisje, trajnim dhe validim.

- Integrimi i metodave të validuara në flukset operacionale të punës, për të rritur kapacitetin hetimor kundër krimit të organizuar.

Aktivitete për masën 2.5.9

- Harmonizimi i procedurave të hetimit të vendngjarjes në të gjitha rajonet, përmes mentorimit, kontrolleve të brendshme dhe rishikimeve periodike të cilësisë.

- Ngritja e një kornize kombëtare **të menaxhimit të cilësisë, duke siguruar zbatim konsistent të standardeve kriminalistike në të gjithë vendin.**

Aktivitete për masën 2.5.10

- Krijimi i një regjistri të centralizuar që dokumenton kalibrimin, mirëmbajtjen, rinovimin dhe nevojat e zëvendësimit për të gjitha pajisjet kriminalistike.

- Zbatimi i mirëmbajtjes së planifikuar dhe procedurave të gjurmueshmërisë, për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e rezultateve kriminalistike.

Aktivitete për masën 2.5.11

- Hartimi i planeve shumëvjeçare të investimeve që përfshijnë prioritetet e prokurimit, nevojat për infrastrukturë, kërkesat e burimeve njerëzore dhe programet e trajnimit.

- Lidhja e prioriteteve të investimeve me objektivat e akreditimit dhe synimet **e përmirësimit të cilësisë, për të siguruar zhvillim strategjik të shërbimeve kriminalistike.**

Aktivitete për masën 2.5.12

- Ndërtimi dhe konfigurimi i Serverit të Stacionit të Kontrollit në Distancë për të mundësuar krahasimin e drejtpërdrejtë të të dhënave daktiloskopike në sistemin AFIS Papillon.

Aktivitete për masën 2.5.13

- Ofrimi i programeve periodike të trajnimit dhe ricertifikimi për ekspertët e vendngjarjes, përfshirë vlerësimet praktike dhe ushtrimet e bazuara në skenarë.

- Kryerja e vlerësimeve periodike të kompetencave, për të garantuar zbatim konsistent të standardeve të cilësisë dhe trajtim të duhur të provave.

Aktivitete për masën 2.5.14

- Pjesëmarrja në rrjetet ndërkombëtare kriminalistike, shkëmbimet dhe nismat e krahasimit, për të përdorur praktikat më të mira dhe metoda novatore.

- Përfshirja e modeleve ndërkombëtarë dhe i mësimeve të nxjerra në politikat kombëtare të zhvillimit të shërbimit kriminalistik.

Aktivitete për masën 2.5.15

- Kryerja e analizës së boshllëqeve ligjore dhe propozimi i ndryshimeve që sqarojnë bazën ligjore, garancitë procedurale, rregullat e zinxhirit të ruajtjes, periudhat e ruajtjes dhe garancitë e mbrojtjes së të dhënave.

- Garantimi që ndryshimet e propozuara të forcojnë efektivitetin hetimor, ndërsa të drejtat themelore respektohen plotësisht.

Aktivitete për masën 2.5.16

- Integrimi, në kurrikulat e trajnimit, i pajisjeve të reja, i mjeteve të dokumentimit digjital, teknikave të parandalimit të kontaminimit dhe moduleve të integritetit të provave.

- Ofrimi i sesioneve praktike të trajnimit mbi sigurimin dhe ekzaminimin e vendngjarjes, duke përdorur metodologji të përditësuara.

Aktivitete për masën 2.5.17

- Përditësimi i moduleve të trajnimit për oficerët e policisë gjyqësore, mbi koordinimin efektiv me ekspertët kriminalistë, trajtimin e provave dhe procedurat e referimit.

- Ofrimi i trajnimit mbi **kërkimin, interpretimin dhe paraqitjen e ekzaminimeve kriminalistike në gjykatë për të forcuar fuqinë provuese.**

Aktivitete për masën 2.5.18

- Rritja e personelit të specializuar dhe prokurimi i mjeteve digjitale moderne të kriminalistikës, për të mbështetur ekzaminimet e pajisjeve elektronike, provave *online* dhe gjurmëve digjitale komplekse.

- Zbatimi i metodologjive të standardizuara dhe trajnimit të vazhdueshëm për të siguruar produkte digjitale kriminalistike të cilësisë së lartë.

Aktivitete për masën 2.5.19

- Hartimi dhe përditësimi i një udhëzuesi vjetor mbi paketimin, ruajtjen dhe trajtimin e provave fizike, përfshirë problematikat e afateve dhe protokollet e marrjes në dorëzim.

- Shpërndarja e udhëzuesit te të gjitha institucionet përkatëse dhe kryerja e trajnimit për të siguruar zbatim konsistent dhe pranueshmëri të përmirësuar të provave kriminalistike.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Progresi i modernizimit të infrastrukturës laboratorike të IPSh dhe statusi i akreditimit ISO.

Produkti 2: Numri i testeve kriminalistike të finalizuara dhe koha mesatare e përpunimit të çështjes.

Produkti 3: Numri i specialistëve kriminalistë të trajnuar dhe të akredituar.

Institucionet përgjegjëse: Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit, Instituti i Policisë Shkencore, FFA, Akademia e Sigurisë;

Institucionet mbështetëse: FFA, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Rezultatet do të maten përmes treguesit të mëposhtëm:

Koha mesatare e përpunimit të çështjeve të forensikës/kriminalistikës (ditë) dhe mbulimi i akreditimit.

Vlera bazë: 2025 – 0.

Synimi deri më 2030: ≤ 5 disiplina forensike të akredituara.

Objektivi Specifik 2.6: Rritja e efektivitetit në gjurmimin, sekuestrim, konfiskimin dhe ripërdorimin e aseteve, duke hequr sistematikisht të ardhurat kriminale dhe duke i riinvestuar për dobi publike

Hartimi i qasjes strategjike ndaj procesit të identifikimit, gjurmimit, konfiskimit dhe ripërdorimit të aseteve që rrjedhin nga krimi është një komponent thelbësor në arkitekturën e politikave kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit. Kjo qasje synon jo vetëm të ndëshkojë aktivitetet kriminale, por edhe të godasë fitimet ekonomike që rezultojnë prej tyre, duke dobësuar drejtpërdrejt strukturat kriminale dhe duke ndërprerë ciklin e paligjshmërisë.

Që kjo qasje të jetë efektive, është e nevojshme të vendosen dhe të veprojnë mekanizma të specializuar për të mundësuar identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale, si ZRA, zhvillimi i hetimeve paralele financiare, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional midis agjencive ligjzbatuese, prokurorisë, administratës tatimore dhe institucioneve të inteligjencës financiare, si dhe rritja e kapaciteteve profesionale në përdorimin e mjeteve të avancuara analitike dhe teknologjike. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkombëtar, veçanërisht në rastet kur asetet janë shpërndarë jashtë territorit të vendit, duke kërkuar mekanizma efektivë për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe zbatimin e vendimeve të huaja të konfiskimit.

Vëmendje e veçantë i kushtohet edhe ripërdorimit të aseteve të konfiskuara bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përdorimit për qëllime publike, si mbështetja për viktimat, forcimi i kapaciteteve institucionale, ose financimi i projekteve sociale dhe komunitare, si dhe ripërdorimi i pasurive të paluajtshme për qëllime sociale, si ndërmarrjet sociale. Kjo jo vetëm rrit efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale, por, gjithashtu, forcon besimin publik tek institucionet shtetërore dhe kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më rezistente. Autoritetet përkatëse do të angazhohen që të ofrojnë dhe të përditësojnë periodikisht informacionin mbi asetet e konfiskuara, ato të administruara dhe të ripërdorura, përfshirë llojin, vlerën e përafërt, statusin aktual dhe destinacionin përfundimtar ose rezultatin e ripërdorimit të tyre social. Aksesi publik në informacion të besueshëm mbi asetet e konfiskuara, rrit transparencën dhe besimin publik te sistemi i drejtësisë dhe te mekanizmat kundër korrupsionit. Demonstrimi që të ardhurat e paligjshme konfiskohen efektivisht dhe riinvestohen për dobi publike, forcon besimin qytetar dhe bën që rikuperimi i aseteve të kontribuojë konkretisht në zhvillimin social dhe komunitar.

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) do të publikojë një regjistër *online*, me akses të hapur të aseteve të konfiskuara dhe ripërdorimit të tyre social, duke prioritizuar projektet që përfitojnë viktimat, të

rinjtë dhe që forcojnë rezistencën komunitare. Objektiva vjetorë të performancës do të përcaktohen për gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin përfundimtar të aseteve, të cilat do të raportohen publikisht, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe koordinim të ngushtë ndërinstitucional midis organeve hetimore, autoriteteve financiare dhe agjencive sociale.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Operacionalizim i plotë i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve me koordinim ndërinstitucional.

Rezultati 2: Rritje sistematike e vlerës së rikuperimit të aseteve dhe numri i urdhrave të konfiskimit të ekzekutuar.

Rezultati 3: Ripërdorim në shkallë të gjerë i aseteve të konfiskuara për interes social dhe komunitar.

Duke iu referuar sa më sipër, për këto dy struktura, ky dokument strategjik ka parashikuar disa masa për arritjen e këtij objektivi si vijon:

Masa 2.6.1: Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit nr. 44/2025 "Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve, duke përcaktuar organizimin e brendshëm, mandatet, flukset e punës dhe procedurat e bashkëpunimit të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, me qëllim përcaktimin e përgjegjësive të qarta operacionale dhe performancës efektive të funksioneve të gjurmimit dhe rikuperimit të aseteve.

Masa 2.6.2: Pjesëmarrja aktive e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në shkëmbimin e informacionit brenda Rrjetit Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve, rrjetit CARIN, si dhe në platformat rajonale/ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve, përfshirë përmes përgjigjeve në kohë ndaj kërkesave, shpërndarjes proaktive të informacionit, pjesëmarrjes në takime dhe trajnime, dhe ndjekjes së koordinuar të veprimeve të gjurmimit të aseteve.

Masa 2.6.3: Përmirësimi i administrimit dhe ripërdorimit të aseteve të konfiskuara, me qëllim ruajtjen dhe/ose rritjen së vlere për ripërdorim të mëvonshëm ripërdorimit, duke forcuar planifikimin e menaxhimit të aseteve, masat e mirëmbajtjes dhe mbrojtjes, praktikat e vlerësimit dhe vendimmarrjen transparente mbi asgjësimin ose ripërdorimin.

Masa 2.6.4: Ripërdorimi i aseteve të konfiskuara, përfshirë ripërdorimin social, brenda 6 muajve nga konfiskimi, duke thjeshtuar procedurat administrative, duke standardizuar rrugët e vendimmarrjes dhe duke forcuar koordinimin midis Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe institucioneve përfituese përkatëse.

Masa 2.6.5: Përmirësimi dhe harmonizimi i praktikave për revokimin e aseteve kriminale, përmes hartimit të metodologjive të përbashkëta, qasjeve konsistente provuese dhe procedurale dhe punës së koordinuar të çështjeve midis autoriteteve përgjegjëse, me qëllim rritjen e sigurisë juridike dhe efektivitetit të rezultateve të rikuperimit të aseteve.

Masa 2.6.6: Identifikimi i nevojave për rritjen e kapaciteteve logjistike për të mbështetur administrimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke vlerësuar strukturat e ruajtjes, modalitetet e sigurisë, pajisjet e transportit dhe trajtimit, nevojat TI dhe kërkesat për burime njerëzore, si dhe duke shndërruar boshllëqet e identifikuara në veprime përmirësimi të prioritizuara.

Masa 2.6.7: Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde operacionale të përbashkëta, ndërmjet Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Zyrës për Rikuperimin e Aseteve (ZRA), përfshirë procedurat për referimin, shkëmbimin e informacionit, kërkesat për gjurmimin e aseteve, përditësimet e regjistrit të aseteve, si dhe masat e koordinuara për ruajtjen, administrimin dhe ripërdorimin.

Masa 2.6.8: Përmirësimi i elementeve funksionale të regjistrit elektronik të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, me përmirësimin e kontrollit të cilësisë së të dhënave, sigurimin e përditësimeve në kohë, përmirësimin e menaxhimit të aksesit të përdoruesit dhe të auditueshmërisë, duke mundësuar funksionalitetet raportuese dhe analitike në mbështetje të vendimmarrjes për administrimin, asgjësimin dhe ripërdorimin.

Masa 2.6.9: Rritja e shkëmbimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar të informacionit në fushën e aseteve të sekuestruara, si dhe sigurimi/zgjerimi i aksesit në bazat e të dhënave përkatëse, përmes kanaleve të sigurta, autorizimeve të qarta dhe modaliteteve të ndërveprueshmërisë, me qëllim përmirësimin e gjurmimit, verifikimit, administrimit dhe ripërdorimit të aseteve në kohë.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.6.1

- Hartimi, konsultimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore që kërkohen për ta bërë ZRA-në plotësisht funksionale, përfshirë organizimin e brendshëm, mandatet, flukset e punës dhe procedurat e bashkëpunimit me organet hetimore dhe të prokurorisë.

- Hartimi i manualeve operacionale të detajuara dhe i diagramit të fluksit të punës për gjurmimin e aseteve, shkëmbimin e informacionit, prioritizimin e çështjeve dhe koordinimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Aktivitete për masën 2.6.2

- Pjesëmarrje e strukturuar në Rrjetin e BE-së të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve, CARIN dhe platformat rajonale, përmes përgjigjeve në kohë ndaj kërkesave, shpërndarjes proaktive të inteligjencës dhe pjesëmarrjes në takime dhe trajnime.

- Koordinimi i veprimeve ndjekëse ndaj kërkesave ndërkufitare **për gjurmim të aseteve, duke kryer verifikim të shpejtë, shkëmbim informacioni dhe mbështetje operacionale për sekuestrim dhe konfiskim.**

Aktivitete për masën 2.6.3

- Forcimi i planifikimit të menaxhimit të aseteve, duke miratuar praktika të standardizuara vlerësimi, protokolle mirëmbajtjeje dhe masa mbrojtëse për ruajtjen apo rritjen e vlerës së aseteve.

- Miratimi i procedurave **transparente vendimmarrës për asgjësimin dhe ripërdorimit, përfshirë kërkesat e dokumentimit, vlerësimet e riskut dhe mekanizmat** e raportimit publik.

Aktivitete për masën 2.6.4

- Harmonizimi i procedurave administrative dhe i praktikës së vendimmarrjes, në mënyrë që asetet e konfiskuara të transferohen për ripërdorim social brenda gjashtë muajve, duke u dhënë prioritet projekteve në dobi të viktimave, të rinjve dhe rezistencës komunitare.

- Forcimi i koordinimit midis AAPSK-së dhe institucioneve përfituese, për të garantuar dorëzim në kohë, përgatitjen e planeve të ripërdorimit dhe monitorimin e zbatimit.

Aktivitete për masën 2.6.5

- Hartimi i metodologjive të përbashkëta dhe standardeve provuese për revokimin e aseteve kriminale, duke siguruar zbatim konsistent në institucionet hetimore, të prokurorisë dhe gjyqësore.

- Mbajtja e takimeve të koordinuara për trajtimin e çështjeve, me qëllim që të harmonizohen qasjet procedurale, të reduktohen pasiguria juridike dhe të rritet efektiviteti i rezultateve të rikuperimit të aseteve.

Aktivitete për masën 2.6.6

- Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të strukturave të ruajtjes, modaliteteve të sigurisë, pajisjeve të transportit dhe trajtimit, sistemeve TI dhe nevojave **për burime njerëzore, për menaxhimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.**

- Shndërrimi i boshllëqeve të identifikuara në veprime përmirësimi të prioritizuara, përfshirë planet e prokurimit, modernizimet e infrastrukturës dhe përshtatjet në personel.

Aktivitete për masën 2.6.7

- Hartimi i procedurave standarde operacionale të përbashkëta që mbulojnë referimet, shkëmbimin e informacionit, kërkesat e gjurmimit të aseteve, përditësimet e regjistrit të aseteve dhe veprimet e koordinuara të mbrojtjes dhe ripërdorimit.

- Trajnimi i personelit të të dyjave institucioneve mbi procedurat standarde operacionale, për të garantuar zbatim konsistent dhe bashkëpunim efikas në flukset e punës gjatë rikuperimit të aseteve.

Aktivitete për masën 2.6.8

- Përmirësimi i regjistrit elektronik duke futur kontrolle të cilësisë së të dhënave, mekanizma përditësimi në kohë, rregulla të përmirësuara të menaxhimit të aksesit dhe funksione auditueshmërie.

- Zhvillimi i funksionaliteteve të raportimit dhe analitike, për të mbështetur vendimmarrjen për administrimin, asgjësimin dhe ripërdorimin social të aseteve të konfiskuara.

Aktivitete për masën 2.6.9

- Miratimi i kanaleve të sigurta dhe i procedurave të qarta të autorizimit për shkëmbimin e informacionit midis organeve hetimore, autoriteteve financiare, AAPSK-së dhe partnerëve ndërkombëtarë.

- Përmirësimi i ndërveprueshmërinë midis bazave përkatëse të të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare për të mbështetur gjurmimin, verifikimin, administrimin dhe ripërdorimin në kohë të aseteve.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Vlera vjetore e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara përmes hetimeve penale.

Produkti 2: Numri i pronave të konfiskuara që janë transferuar te qeverisja vendore për ripërdorim social.

Produkti 3: Numri i çështjeve ndërkufitare të rikuperimit të aseteve të finalizuara.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Institucionet mbështetëse: Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Vlera kumulative vjetore e pasurive të konfiskuara dhe ripërdorura për qëllime sociale (në milionë lekë)

Vlera bazë: 2025 – vlera e pasurive të konfiskuara 180,670, 028.798 lekë.

Synimi deri më 2030: do të konfirmohet në vitin 2026.

Objektivi Specifik 2.7: Përmirësimi i matshëm në hetimet dhe ndjekjet penale të udhëheqësve dhe anëtarëve të strukturave të krimit të organizuar, e demonstruar me rritjen e dënimeve të rënda dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Themelimi i strukturave të reja të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbën një zhvillim pozitiv dhe premtues për përballimin e grupeve kriminale dhe ndëshkimin e liderëve dhe anëtarëve të tyre. Për të garantuar rezultate të qëndrueshme dhe të prekshme në këtë drejtim, prioritet do t'i jepet rritjes së efikasitetit të hetimeve penale, me një fokus të veçantë në identifikimin dhe ndjekjen penale të organizatorëve dhe financuesve të aktiviteteve kriminale. Kjo do të mbështetet përmes forcimit të kapaciteteve teknike, ndërmarrjes së investimeve strategjike për hetime të thelluara, cilësore dhe proaktive, si dhe përmirësimit të mëtejshëm të kornizës ligjore. Objektivi kryesor mbetet rritja e efektivitetit të përgjithshëm në luftën kundër strukturave të organizuara kriminale.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritje e përqindjes së hetimeve të krimit të organizuar, bazuar në inteligjencë dhe vlerësim të kërcënimeve.

Rezultati 2: Norma më të larta dënimi dhe dënime më të ashpra për udhëheqësit e grupeve të krimit të organizuar.

Rezultati 3: Ndërprerje e demonstruar e rrjeteve kryesore të krimit të organizuar.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 2.7.1: Konsolidimi të dhënave statistikore mbi veprat penale të krimit të organizuar, përmes përdorimit të vazhdueshëm të platformës elektronike, duke siguruar hyrje të rregullt të të dhënave, validim, kontroll cilësie dhe raportim analitik për të mbështetur planifikimin operacional dhe vendimmarrjen strategjike.

Masa 2.7.2: Bërja efektive e Seksionit të Përgjimit Parandalues në Byronë Kombëtare të Hetimit.

Masa 2.7.3: Ngritja e një sistemi analize në BKH për vlerësimin e kërcënimeve në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Masa 2.7.4: Zbatimi regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë, për subjektet me rrezik të theksuar kriminal, përfshirë kategorizimin e jashtëm dhe të brendshëm dhe vlerësimin progresiv të rrezikut të këtyre subjekteve, me qëllim reduktimin e ndikimit të krimit të organizuar brenda strukturave të burgimit dhe forcimin e sigurisë institucionale.

Masa 2.7.5: Rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe ndjekjes së vazhdueshme, duke vlerësuar dhe mbledhur informacion mbi rastet e korrupsionit, abuzimit dhe veprave penale brenda sistemit të vuajtjes së dënimit, përfshirë përmes mbledhjes së inteligjencës, shënjestrimit të bazuar në rrezik dhe referimeve në kohë tek organet përgjegjëse hetimore dhe të prokurorisë.

Masa 2.7.6: Parandalimi dhe goditja e krimeve në burgjet e vendit, në bashkëpunim me SPAK-un, prokuroritë e rretheve gjyqësore, si dhe agjencitë ligjzbatuese, përfshirë përmes veprimeve të koordinuara operacionale, shkëmbimit të strukturuar të informacionit dhe planifikimit të përbashkët për hetime dhe ndërhyrje.

Masa 2.7.7: Rritja e përdorimit të metodave të posaçme të hetimit, me qëllim zbulimin dhe dokumentimin e aktiviteteve kriminale, përfshirë përgjimin, infiltrimin, mbikëqyrjen fizike, dhe rritjen e performancës profesionale të oficerëve që zbatojnë këto metoda përmes trajnimit të specializuar, mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë.

Masa 2.7.8: Rritja e efektivitetit të hetimeve kundër krimit të organizuar, me fokus tek udhëheqësit dhe financuesit, duke kryer hetime të avancuara financiare me qëllimin e identifikimit dhe sekuestrimit të aseteve që rrjedhin nga krimi, përfshirë përmes hetimeve paralele financiare dhe mbështetjes së zgjeruar analitike.

Masa 2.7.9: Rritja e efektivitetit të bashkëpunimit me partnerët për të zbuluar krimin e organizuar, përmes takimeve periodike, analizave dhe trajnimeve të përbashkëta, shkëmbimit të strukturuar të informacionit, dhe lidhjes e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Masa 2.7.10: Hartimi i raportit "Vlerësimi i kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimit të rëndë", përmes të cilit kërcënimet që paraqet krimi i organizuar dhe krimi i rëndë do të identifikohen, analizohen dhe vlerësohen, me qëllim përcaktimin e prioriteteve për një luftë më efektive kundër rimit, edhe përmes planifikimit strategjik dhe operacional të bazuar në të dhëna.

Masa 2.7.11: Kryerja e analizave dhe vlerësimeve periodike të rrezikut të grupeve kriminale që veprojnë në Shqipëri, duke i renditur grupet aktive sipas nivelit të rrezikut, me qëllim prioritizimin dhe shënjestrimin e masave operacionale për ndërprerjen, hetimin dhe ndjekjen penale.

Masa 2.7.12: Rinovimi i pajisjes Router-VPN të instaluar në serverat e INTERPOL NCB Tirana, që mundëson enkriptim të komunikimeve në sistemin e INTERPOL-it, për të garantuar shkëmbim të sigurt të informacionit dhe për të ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave që transmetohen.

Masa 2.7.13: Reduktimi i kërcënimeve ndaj jetës dhe shëndetit të individëve (përfshirë vrasjet, lëndimet e rënda), edhe përmes masave parandaluese të shënjestruara, planifikimit operacional të bazuar në rrezik dhe veprimeve të koordinuara, për shkurajimin, zbulimin dhe ndërprerjen e aktivitetit kriminal të dhunshëm.

Masa 2.7.14: Rritja e hetimeve proaktive për parandalimin, gjurmimin, zbulimin dhe arrestimin e individëve dhe grupeve kriminale të përfshira në krimet e rënda ndaj jetës dhe shëndetit, përmes forcimit të mbledhjes së të dhënave, zbatimit të metodave të posaçme të hetimit, ku lejohet me ligj, si dhe prioritizimit të shkelësve dhe grupeve me rrezik të lartë.

Masa 2.7.15: Blerja e pajisjeve për aplikimin e identifikimit biometrik të personit LTA, duke siguruar specifikimet teknike, instalimin e sigurt, trajnimin e personelit dhe integrimin me bazat përkatëse të të dhënave dhe rrjedhat operacionale të punës për të mbështetur identifikimin e saktë dhe veprimet ligjzbatuese.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.7.1

- Sigurimi i hedhjes së rregullt të të dhënave, certifikim dhe kontroll të cilësisë në platformën elektronike nga të gjitha strukturat përgjegjëse, duke mundësuar raportim statistikor të saktë dhe në kohë.
- Prodhimi i raporteve analitike periodike bazuar në të dhënat e konsoliduara, për të mbështetur planifikimin operacional, vlerësimet e kërcënimeve dhe vendimmarrjen **strategjike.**

Aktivitete për masën 2.7.2

- Plotësimi i personelit, procedurave operacionale dhe flukseve të brendshme të punës për Seksionin e Mbikëqyrjes Parandaluese, duke garantuar operacione mbikëqyrjeje të ligjshme dhe efikase.
- Pajisja e Seksionit me mjete moderne mbikëqyrjeje dhe miratimi i mekanizmave të qartë të koordinimit me organet hetimore dhe të prokurorisë, për veprime ndjekëse.

Aktivitete për masën 2.7.3

- Hartimi i metodologjive analitike, protokolleve të mbledhjes së të dhënave dhe formateve të raportimit, për të vlerësuar kërcënimet e lidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin.
- Prodhimi i produkteve analitike periodike, si vlerësime kërcënimesh, matrica risku dhe instruktazhe shënjestrimi, për të udhëhequr prioritizimin dhe alokimin e burimeve.

Aktivitete për masën 2.7.4

- Zbatimi i procedurave të klasifikimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe i vlerësimeve progresive të rrezikut për të burgosurit me rrezik të lartë, për të reduktuar ndikimin e tyre brenda strukturave të vuajtjes së dënimit.
- Forcimi i masave operacionale të sigurisë dhe sistemeve të monitorimit, për të parandaluar komunikimin, koordinimin ose aktivitetin kriminal nga brenda burgjeve.

Aktivitete për masën 2.7.5

- Shënjestrimi bazuar në mbledhjen e inteligjencës dhe në rrezik, me qëllim identifikimin e

korrupsionit, abuzimit dhe aktivitetit kriminal brenda burgjeve.

- Referim në kohë i rasteve të identifikuara tek organet përgjegjëse hetimore dhe të prokurorisë, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i ecurisë së çështjeve.

Aktivitete për masën 2.7.6

- Miratimi i mekanizmave të strukturuar për shkëmbimin e informacionit midis SPAK-ut, prokurorëve të rrethit dhe agjencive ligjzbatuese, në zbulimin dhe trajtimin e aktivitetit kriminal në burgje.

- Kryerja e veprimeve operacionale të koordinuara dhe të sesioneve të përbashkëta të planifikimit për hetimin, ndërprerjen dhe ndjekjen penale të rrjeteve kriminale që veprojnë brenda strukturave të vuajtjes së dënimit.

Aktivitete për masën 2.7.7

- Zgjerimi i përdorimit të ligjshëm të metodave të posaçme të hetimit, si përgjimi, infiltrimi dhe mbikëqyrja fizike, me qëllim zbulimin dhe dokumentimin e aktiviteteve të krimit të organizuar.

- Ofrimi i trajnimit të specializuar, mbikëqyrjes dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë, për të rritur performancën profesionale të oficerëve që zbatojnë këto metoda.

Aktivitete për masën 2.7.8

- Kryerja e hetimeve financiare të avancuara paralelisht me hetimet penale, për identifikimin, gjurmimin dhe sekuestrimin e aseteve që rrjedhin nga krimi i organizuar.

- Forcimi i mbështetjes analitike dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për shënjestrimin e individëve me vlerë të lartë, financuesve dhe lehtësuesve brenda rrjeteve kriminale.

Aktivitete për masën 2.7.9

- Zhvillimi i takimeve koordinuese periodike, analizave të përbashkëta dhe trajnimeve të përbashkëta me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për zbulimin dhe ndërprerjen e aktivitetit të krimit të organizuar.

- Forcimi i mekanizmave të strukturuar të shkëmbimit të informacionit dhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, për të mbështetur hetimet e përbashkëta dhe veprimet operacionale.

Aktivitete për masën 2.7.10

- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave nga autoritetet ligjzbatuese, inteligjenca dhe organet rregullatorë, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve që rrjedhin nga krimi i organizuar dhe i rëndë.

- Përgatitja e një raporti gjithëpërfshirës të kërcënimeve, për të udhëhequr planifikimin strategjik dhe operacional të bazuar në të dhëna.

Aktivitete për masën 2.7.11

- Hartimi dhe zbatimi i metodologjisë për renditjen e grupeve kriminale aktive bazuar në rrezik, nivel kërcënimi dhe ndikim operacional.

- Përdorimi i vlerësimeve të rrezikut për të prioritizuar veprimet operacionale, hetimet dhe përpjekjet e ndërprerjes kundër grupeve me rrezik të lartë.

Aktivitete për masën 2.7.12

- Prokurimi dhe instalimi i pajisjes së re Router VPN për të garantuar komunikim të sigurt dhe të enkriptuar brenda sistemit të INTERPOL-it.

- Kryerja e testimit dhe konfigurimit, si edhe trajnimi i personelit për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe shkëmbimin e pandërprerë të informacionit.

Aktivitete për masën 2.7.13

- Kryerja e planifikimit operacional të bazuar në rrezik dhe në masa parandalimi të shënjestruar, me qëllim shkurajimin dhe ndërprerjen e aktivitetit kriminal të dhunshëm, përfshirë vrasjet dhe lëndimet e rënda.

- Koordinimi i veprimeve midis strukturave policore për të identifikuar individët me rrezik të lartë, për të parandaluar përshkallëzimin dhe për t'iu përgjigjur me shpejtësi kërcënimeve që shfaqen rishtas.

Aktivitete për masën 2.7.14

- Forcimi i mbledhjes së inteligjencës dhe zbatimi i metodave të posaçme të hetimit, për zbulimin dhe gjurmimin e individëve dhe grupeve të përfshira në krime të rënda dhe të dhunshme.

- Prioritizimi i hetimeve që shënjestrojnë shkelësit me rrezik të lartë dhe grupet e organizuara, përgjegjëse për vepra të dhunshme të përsëritura ose me ndikim të lartë.

Aktivitete për masën 2.7.15

- Prokurimi i pajisjeve të identifikimit biometrik me specifikime teknike të përshtatshme, si dhe instalimi i sigurt dhe integrimi me bazat përkatëse të të dhënave.

- Trajnimi i personelit operacional dhe integrimi i flukseve biometrike të punës në procedurat hetimore dhe ekzekutuese për të mbështetur identifikimin e saktë.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i rrjeteve prioritare të krimit të organizuar të identifikuara dhe të shënjestruara.

Produkti 2: Numri i operacioneve të task-forcës së përbashkët të kryera kundër shenjëstrave prioritare.

Produkti 3: Numri i dënimeve të lidhura me grupet e krimit të organizuar, si dhe rezultatet e rikuperimit të aseteve.

Institucionet përgjegjëse: Ministria e Drejtësisë, Byroja Kombëtare e Hetimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale/AMSEVP; Policia e Shtetit.

Institucionet mbështetëse: Byroja Kombëtare e Hetimit, Prokuroria e Posaçme, Gjykatat, Policia e Shtetit, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ i Shtetit, Ministria e Punëve të Brendshme, INTERPOL.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Numri i procedimeve penale të referuara në gjykatë në lidhje me krimin e organizuar dhe krimin e rëndë, dhe numri i personave të ndjekur penalisht.

Vlera bazë: do të konfirmohet në 2026;

Synimi deri më 2030: do të konfirmohet në 2026.

Objektivi Specifik 2.8: Reduktimi i ndjeshëm i krimit mjedisor, përmes përmirësimit të mekanizmave të zbulimit, forcimit të kapaciteteve të specializuara hetimore dhe të ndjekjes penale, zhvillimit të hetimeve financiare dhe konfiskimit të përfitimeve të paligjshme, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkufitar

Forcimi i mekanizmave për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e krimeve mjedisore është i nevojshëm për mbrojtjen e ekosistemeve dhe burimeve natyrore. Përmirësimi i kapaciteteve të autoriteteve ligjzbatuese dhe përdorimi i teknologjive moderne mundëson identifikimin dhe synimin e grupeve të organizuara kriminale që veprojnë në mënyrë të paligjshme kundër mjedisit.

Kjo përfshin ndërhyrje efektive në prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, nxjerrjen e paligjshme të mineraleve (rërë dhe zhavorr), krimet ndaj kafshëve të egra dhe tregtinë/kontrabandën e paligjshme, ndërtimet e paautorizuara në zona të mbrojtura dhe shkatërrimin e habitatit natyror, si dhe forcimin e bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore dhe organizatave mjedisore. Monitorimi i krimit mjedisor do të bazohet në një sistem të integruar të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave ndërinstitucionale, bazuar kërkesat e nenit 22 të Direktivës (BE) 2024/1203, duke siguruar gjurmueshmërinë e rasteve nga identifikimi deri në vendimmarrjen përfundimtare dhe konfiskimin e përfitimeve të paligjshme.

Në këtë mënyrë, përmes zbatimit të masave, synohet të reduktohen ndjeshëm rastet e ndotjes së qëllimshme, prerjes së paligjshme dhe dëmtimeve të tjera mjedisore, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm mbikëqyrjeje dhe ndëshkimi. Kjo forcon llogaridhënien ligjore për shkeljet mjedisore dhe rrit ndërgjegjësimin publik për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social, duke siguruar mirëqenie afatgjatë dhe ruajtje të burimeve natyrore.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Ngritja e kapaciteteve të specializuara të hetimit dhe ndjekjes penale të krimit mjedisor.

Rezultati 2: Rritja e zbulimit dhe ndjekjes penale të veprave të krimit mjedisor.

Rezultati 3: Koordinim i përmirësuar ndërinstitucional për mbrojtjen dhe zbatimin mjedisor.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 2.8.1: Rritja e aktivitetit hetimor parandalues dhe proaktiv kundër krimeve mjedisore, me qëllim përmirësimin e mekanizmave mbrojtës dhe identifikimin e hershëm të veprave penale mjedisore, përfshirë përmes shënjestrimit të bazuar në rrezik, patrullimeve dhe inspektimeve të udhëhequra nga inteligjenca, si dhe nisjes në kohë të hetimeve proaktive.

Masa 2.8.2: Forcimi i shkëmbimit të informacionit si mjet strategjik për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e hetimeve të veprave penale që lidhen me krimet mjedisore, në bashkëpunim me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, përfshirë përmes koordinimit të strukturuar të çështjeve, referimeve në kohë dhe ndarjes së pistave hetimore, nevojave provuese dhe produkteve analitike.

Masa 2.8.3: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në shkëmbimin e informacionit mbi krimin mjedisor, përmes kanaleve të sigurta të komunikimit, me qëllim sigurinë mjedisore globale dhe kombëtare, duke promovuar bashkëpunimin ndërkufitar dhe hetimet e përbashkëta, si dhe duke përdorur mjetet dhe mekanizmat përkatës sipas UNTOC (Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional) për të luftuar prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve, dhe trafikimin e kafshëve të egra.

Masa 2.8.4: Ofrimi i trajnimit të përbashkët për oficerët e agjencive ligjzbatuese mbi identifikimin, zbulimin dhe referimin (kualifikimin) e krimeve mjedisore, përfshirë trajnimin mbi tipologjitë e krimit mjedisor, kërkesat e mbledhjes së provave dhe procedurat e koordinimit me inspektorët dhe prokurorët.

Masa 2.8.5: Krijimi dhe operacionalizimi i njësive të specializuara për identifikimin dhe hetimin e krimeve mjedisore, duke përcaktuar mandatet, profilet e personelit, mekanizmat e koordinimit me inspektoratet mjedisore dhe prokurorët, dhe përdorimin e mjeteve dhe metodologjive të specializuara për zbulimin dhe zhvillimin e çështjes.

Masa 2.8.6: Integrimi i kurrikulave të krimit mjedisor në Akademinë e Sigurisë, si dhe hartimi i moduleve të specializuara të trajnimit ndërinstitucional për hetuesit financiarë, prokurorët dhe inspektorët mjedisorë, përfshirë module për korrupsionin e gjelbër, të ardhurat mjedisore nga krimi, si dhe flukset e paligjshme financiare që rrjedhin nga krimet mjedisore, me qëllim forcimin e parandalimit, zbulimit dhe ndërtimit efektiv të çështjes.

Masa 2.8.7: Përfshirja e kurrikulave të krimit mjedisor në Shkollën e Magjistraturës për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të magjistratëve, përfshirë modulet mbi kualifikimin e veprave, standardet provuese, të ardhurat e krimit mjedisor dhe përdorimin e ekspertizës së specializuar dhe koordinimit ndërinstitucional në procedimet e krimit mjedisor.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.8.1

- Kryerja e patrullimeve të shënjestruara, të bazuara në rrezik dhe të udhëhequra nga inteligjenca, në zonat me rrezik të lartë për prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve, krimin ndaj kafshëve të egra dhe nxjerrjen e paautorizuar të burimeve natyrore, duke siguruar identifikim të hershëm të veprave.
- Nisja e hetimeve proaktive bazuar në tregues të rrezikut mjedisor, imazhe satelitore, monitorim me drone dhe raportim komunitar, duke mundësuar ndërhyrje në kohë dhe zhvillim të çështjes.

Aktivitete për masën 2.8.2

- Krijimi i mekanizmave të strukturuar të koordinimit të çështjes me prokurorët, përfshirë takime të rregullta, rishikim të përbashkët të pistave hetimore dhe referime në kohë të veprave të dyshuara mjedisore.
- Shpërndarja e produkteve analitike, nevojave provuese dhe konstatimeve hetimore për të përmirësuar cilësinë e çështjes dhe për të siguruar kualifikim dhe ndjekje konsistente të krimeve mjedisore.

Aktivitete për masën 2.8.3

- Përdorimi i kanaleve të sigurta të komunikimit dhe mekanizmave të UNTOC-ut për shkëmbimin e informacionit me autoritetet e huaja mbi prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve, kontrabandën e kafshëve të egra dhe veprat mjedisore ndërkufitare.
- Pjesëmarrja në hetime të përbashkëta, operacione ndërkufitare dhe task-forca ndërkombëtare për të goditur rrjetet transnacionale të krimit mjedisor.

Aktivitete për masën 2.8.4

- Ofrimi i trajnimit të specializuar mbi tipologjitë e krimit mjedisor, kërkesat e mbledhjes së provave dhe procedurat e koordinimit me inspektorët mjedisorë dhe prokurorët.
- Kryerja e ushtrimeve të përbashkëta praktike që simulojnë dokumentimin e vendit të krimit, marrjen e mostrave dhe proceset e referimit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Aktivitete për masën 2.8.5

- Ngritja e njësive të specializuara me mandate të përcaktuara, profile personeli dhe procedura operacionale për zbulimin dhe hetimin e krimeve mjedisore.
- Pajisja e njësive me mjete të specializuara, si GPS, kite për marrje mostrash, drone dhe mjete të hartëzimit digjital, si dhe koordinimi i strukturuar me inspektoratet mjedisore dhe prokurorët.

Aktivitete për masën 2.8.6

- Futja e moduleve të krimit mjedisor në programet e Akademisë së Sigurisë, përfshirë korrupsionin e gjelbër, të ardhurat mjedisore nga

krimi dhe flukset e paligjshme financiare të lidhura me veprat mjedisore.

- Përgatitja e moduleve të trajnimit ndërinstitucional për hetuesit financiarë, prokurorët dhe inspektorët mjedisorë, me qëllim forcimin e kapaciteteve të parandalimit, zbulimit dhe ndërtimit të çështjes.

Aktivitete për masën 2.8.7

- Përgatitja e moduleve të specializuara të trajnimi për magjistratët mbi kualifikimin e veprave mjedisore, standardet provuese dhe përdorimin e dëshmisë së ekspertit në çështjet e krimit mjedisor.

- Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm mbi të ardhurat e krimit mjedisor, koordinimin ndërinstitucional dhe ndjekjen gjyqësore të çështjeve komplekse të krimit mjedisor.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Njësia e hetimit të krimit mjedisor e ngritur dhe funksionale.

Produkti 2: Numri i hetimeve të krimit mjedisor të nisura dhe çështjeve të ndjekura penalisht.

Produkti 3: Numri i ndjekjeve dhe dënimeve të krimit mjedisor.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit/Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës.

Institucionet mbështetëse: Prokuroria e Përgjithshme; Byroja Kombëtare e Hetimit; Ministria e Mjedisit; Inspektorati i Përgjithshëm; Policia e Shtetit.

Rezultatet do të maten përmes treguesit të mëposhtëm:

Numri vjetor i hetimeve dhe ndjekjeve penale për krimet mjedisore.

Vlera bazë: do të konfirmohet në 2026;

Synimi deri më 2030: do të konfirmohet në 2026.

Objektivi Specifik 2.9: Rritja efektivitetit të ndjekjes ndërkombëtare të personave të kërkuar, e demonstruar përmes normave më të larta të arrestimit dhe ekzekutimit në kohë të procedurave të ekstradimit

SHTYLLA II: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE SHKËMBIMI I NJOHURIVE
Veprimi 2.1: Programi i informimit mbi tregun e Bashkimit Evropian
Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF
Veprimi 2.3: Përgatitja e materialeve praktike informuese
Veprimi 2.4: Përafrimi rregullator me kuadrin e Bashkimit Evropian për sektorin e tekstileve dhe këpucëve
SHTYLLA III: ZHVILLIMI I PARTNERITETEVE DHE INTEGRIMI EVROPIAN
Veprimi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi i partnerëve evropianë
Veprimi 3.2 Bashkëpunimi me shoqatat dhe rrjetet industriale evropiane
Veprimi 3.3: Aktivitete për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (*Business-to-Business* – B2B)
Veprimi 3.4: Partneritete për inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive

SHTYLLA IV: NGRITJA E KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE
Veprimi 4.1: Programi i trajnimit mbi mundësitë e tregut të Bashkimit Evropian
Veprimi 4.2: Programi për gatishmërinë për eksport dhe zhvillimin e biznesit
Veprimi 4.3: Vizita studimore dhe aktivitete për shkëmbimin e përvojës
7. *IMPLEMENTATION ARRANGEMENTS*
8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI
9. REZULTATET E PRITSHME
9. TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPI)
11. ANEKSET

PLANI I VEPRIMIT PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN, ZHVILLIMIN E PARTNERITETEVE DHE INTEGRIMIN EVROPIAN TË ZINXHIRIT TË VLERËS SË SEKTORIT TË TEKSTILEVE, VESHJEVE, LËKURËS DHE KËPUCËVE (TCLF) NË SHQIPËRI 2026–2027

1. HYRJE

Ky Plan Veprimi është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) si një nismë pilot, në kuadër të masës 1.1.6 të Agjendës së Reformave, e cila synon promovimin e eksporteve, ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve, lehtësimin e tregtisë dhe mbështetjen e zinxhirëve industrialë të vlerës me potencial rritjeje.

Sektori i tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) është përzgjedhur si sektori prioritar pilot, për shkak të rëndësisë së tij strategjike për ekonominë shqiptare, orientimit të tij të fortë drejt eksporteve, integrimit në rrjetet evropiane të prodhimit, si dhe potencialit të tij për zhvillim të mëtejshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me partnerët evropianë.

Ky Plan Veprimi mbështetet në punën analitike të kryer nga ministria përmes katër raporteve sektoriale, të cilat trajtojnë vlerësimin e zinxhirit të vlerës, analizën e kuadrit rregullator, masat mbështetëse, si dhe mundësitë për integrimin në zinxhirët industrialë evropianë të vlerës.

Puna analitike identifikoi një sërë sfidash kryesore që ndikojnë në konkurrueshmërinë dhe ndërkombëtarizimin e zinxhirit të vlerës së sektorit TCLF në Shqipëri. Raportet evidentuan dukshmërinë e kufizuar ndërkombëtare të prodhuesve shqiptarë, pjesëmarrjen e pamjaftueshme në rrjetet industriale dhe të biznesit evropian, aksesin e kufizuar në informacionin mbi tregjet, sfidat në rritje që lidhen me agjendën e Bashkimit Evropian për qëndrueshmërinë dhe ekonominë qarkulluese, si dhe mangësitë në aftësi dhe kompetenca që ndikojnë në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve. Në të njëjtën kohë, analiza identifikoi mundësi të rëndësishme që burojnë nga rritja e kërkesës për *nearshoring*, zhvillimi i zinxhirëve evropianë të furnizimit më elastikë dhe baza e konsoliduar prodhuese e Shqipërisë. Këto gjetje përbëjnë bazën faktike mbi të cilën janë përcaktuar prioritetet dhe veprimet e përfshira në këtë Plan Veprimi.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi është të krijojë një kuadër të koordinuar veprimesh, që synon forcimin e ndërkombëtarizimit, konkurrueshmërisë dhe integrimit evropian të sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF), nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, zhvillimit të partneriteteve, promovimit të sektorit dhe ngritjes së kapaciteteve.

2. KONTEKSTI

Sektori i tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) vijon të jetë një nga sektorët më të rëndësishëm të industrisë përpunuese dhe të orientuar drejt eksporteve në Shqipëri. Ky sektor mban marrëdhënie të qëndrueshme tregtare me tregjet evropiane, veçanërisht me Italinë dhe Gjermaninë, dhe luan një rol të rëndësishëm në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik rajonal.

Në të njëjtën kohë, ekosistemi evropian i tekstileve po kalon një proces të rëndësishëm transformimi, i udhëhequr nga objektivat për qëndrueshmërinë, parimet e ekonomisë qarkulluese, digjitalizimi dhe kërkesa në rritje për zinxhirë furnizimi më elastikë dhe gjeografikisht më pranë tregjeve evropiane.

Këto zhvillime krijojnë mundësi të reja për ndërmarrjet shqiptare që të forcojnë pozicionin e tyre në zinxhirët evropianë të vlerës, përmes intensifikimit të bashkëpunimit, rritjes së dukshmërisë, zhvillimit të partneriteteve më të forta dhe pjesëmarrjes më aktive në rrjetet industriale evropiane.

Për këtë arsye, ky Plan Veprimi synon të mbështesë ndërmarrjet në përshtatjen me kushtet në

ndryshim të tregut, duke lehtësuar njëkohësisht integrimin më të ngushtë me partnerët dhe nismat evropiane.

Raportet analitike arritën, gjithashtu, në përfundimin se forcimi i konkurrueshmërisë së zinxhirit të vlerës së sektorit TCLF kërkon një qasje të koordinuar, e cila kombinon promovimin e eksporteve, përmirësimin e aksesit në informacion mbi tregjet, forcimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve, përafrimin gradual të kuadrit rregullator me zhvillimet e kuadrit rregullator të Bashkimit Evropian, si dhe ngritjen e kapaciteteve të ndërmarrjeve. Veprimet e parashikuara në këtë Plan Veprimi i përgjigjen drejtpërdrejt këtyre rekomandimeve dhe synojnë të lehtësojnë integrimin gradual të ndërmarrjeve shqiptare në ekosistemet industriale dhe zinxhirët evropianë të vlerës.

Zbatimi i këtij Plani Veprimi plotëson Programin Kombëtar për Promovimin e Eksporteve, të miratuar nga qeveria, në dhjetor të vitit 2025. Ndërsa Programi Kombëtar për Promovimin e Eksporteve parashikon masa mbështetëse me karakter horizontal për eksportuesit shqiptarë, ky Plan Veprimi fokusohet në mënyrë të veçantë te zinxhiri i vlerës së sektorit TCLF dhe parashikon veprime të synuara për forcimin e partneriteteve ndërkombëtare, promovimin sektorial, integrimin evropian dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, duke shmangur njëkohësisht mbivendosjen e aktiviteteve.

3. VIZIONI

Të forcohet konkurrueshmëria dhe prania ndërkombëtare e sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF), si dhe të lehtësohet integrimi më i thellë i tij në ekosistemet industriale dhe zinxhirët evropianë të vlerës.

4. OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Të promovohet ndërkombëtarizimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zinxhirit të vlerës së sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF), nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit, shkëmbimit të njohurive, zhvillimit të partneriteteve të biznesit dhe intensifikimit të angazhimit me tregjet dhe institucionet evropiane.

5. OBJEKTIVAT SPECIFIKË

OS1

Të rritet vizibiliteti dhe promovimi i sektorit të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) në tregjet evropiane.

OS2

Të përmirësohet aksesi në informacion dhe njohuri mbi zhvillimet, dhe mundësitë në tregjet evropiane.

OS3

Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe kompanive, organizatave dhe institucioneve evropiane.

OS4

Të mbështetet krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve, inovacioni dhe transferimi i njohurive.

OS5

Të forcohen aftësitë dhe kapacitetet e ndërmarrjeve dhe punëmarrësve që veprojnë në zinxhirin e vlerës së sektorit TCLF.

6. SHTYLLAT STRATEGJIKE DHE VEPRIMET

Veprimet e përfshira në secilën shtyllë strategjike janë hartuar mbi bazën e gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve analitike të përgatitura nga ministria. Çdo veprim adreson sfidat dhe mundësitë e identifikuara përgjatë zinxhirit të vlerës së sektorit TCLF dhe kontribuon në forcimin e konkurrueshmërisë, ndërkombëtarizimit dhe integrimit të tij në ekosistemet industriale evropiane.

SHTYLLA I: PROMOVIMI DHE NDËRKOMBËTARIZIMI

Objektivi

Të rritet dukshmëria e ndërmarrjeve shqiptare të sektorit të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) dhe të lehtësohet aksesi i tyre në tregjet evropiane dhe mundësitë e biznesit.

Veprimi 1.1: Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare tregtare

Aktivitetet:

- Lehtësimi i pjesëmarrjes së ndërmarrjeve shqiptare në panairet kryesore evropiane të tekstilit dhe modës;
- Organizimi i pjesëmarrjes me përfaqësim kombëtar në aktivitete të përzgjedhura ndërkombëtare;
- Promovimi i kapaciteteve prodhuese dhe potencialit eksportues të Shqipërisë.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 1.2: Promovimi i Shqipërisë si destinacion për *nearshoring* dhe prodhim

Aktivitetet:

- Përgatitja e materialeve promovuese që prezantojnë sektorin shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF);
- Hartimi i një direktorie digjitale të prodhuesve shqiptarë;
- Promovimi i kapaciteteve prodhuese të Shqipërisë në tregje të përzgjedhura të Bashkimit Evropian.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 1.3: Forumi Vjetor i Partneritetit Shqipëri–BE për sektorin TCLF

Aktivitetet:

- Organizimi i Forumit Vjetor të Partneritetit Shqipëri–BE për sektorin TCLF, me pjesëmarrjen e institucioneve publike, shoqatave të biznesit dhe aktorëve evropianë;
- Prezantimi i mundësive për investime, eksporte dhe bashkëpunim në sektorin shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF);
- Promovimi i dialogut për politikat dhe i bashkëpunimit institucional në mbështetje të integrimit të zinxhirit të vlerës së sektorit shqiptar TCLF në ekosistemet industriale evropiane.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: Çdo vit

SHTYLLA II: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE SHKËMBIMI I NJOHURIVE

Objektivi

Të rritet niveli i ndërgjegjësimit të ndërmarrjeve mbi zhvillimet e tregut, tendencat në fushën e qëndrueshmërisë dhe mundësitë që ofron ekosistemi evropian i tekstileve.

Veprimi 2.1: Programi i Informimit mbi Tregun e Bashkimit Evropian

Aktivitetet:

- Organizimi i sesioneve informuese dhe punëtorive;
- Shpërndarja e informacionit mbi tendencat në fushën e qëndrueshmërisë dhe zhvillimet që lidhen me ekonominë qarkulluese;
- Informimi mbi kërkesat dhe mundësitë në zhvillim të tregut evropian.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF

Aktivitetet:

- Zhvillimi i një platforme elektronike informimi për sektorin;
- Sigurimi i aksesit në informacion praktik, mundësi dhe burime të dobishme;
- Publikimi i përditësimeve mbi zhvillimet me rëndësi për sektorin;
- Promovimi i përdorimit të Platformës së Ekosistemit Evropian të Tekstileve dhe lehtësimi i aksesit të ndërmarrjeve shqiptare në informacionin dhe shërbimet përkatëse evropiane;
- Vendosja e lidhjeve ndërmjet platformës kombëtare të informimit dhe platformave evropiane përkatëse të informimit, si dhe rrjeteve të mbështetjes së biznesit.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026

Veprimi 2.3: Përgatitja e materialeve praktike informuese

Aktivitetet:

- Përgatitja e udhëzuesve mbi mundësitë për eksport;
- Publikimi i materialeve informuese mbi programet dhe nismat evropiane;
- Zhvillimi i burimeve praktike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) që operojnë në sektorin TCLF.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 2.4: Përafrimi rregullator me kuadrin e Bashkimit Evropian për sektorin e tekstileve dhe këpucëve

Aktivitetet:

- Monitorimi i zhvillimeve në legjislacionin e Bashkimit Evropian që lidhen me ekosistemin e tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve;
- Përgatitja e vlerësimeve mbi zhvillimet rregullatore dhe identifikimi i fushave që kërkojnë përafrim gradual;
- Organizimi i konsultimeve me institucionet publike, shoqatat e biznesit dhe ndërmarrjet mbi kërkesat e ardhshme rregullatore të Bashkimit Evropian;
- Mbështetja e përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të masave prioritare rregullatore dhe të politikave të identifikuara në Raportin e Analizës Rregullatore, në përputhje me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe me përafrimin progresiv me **acquis**-in e Bashkimit Evropian në fushën e tekstileve dhe këpucëve.

Institucioni përgjegjës: MEI
Afati kohor: 2026–2027

SHTYLLA III: ZHVILLIMI I PARTNERITETEVE DHE INTEGRIMI EVROPIAN

Objektivi

Të forcohet bashkëpunimi dhe lidhjet e biznesit ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe evropianë.

Veprimi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi i partnerëve evropianë

Aktivitetet:

- Identifikimi i partnerëve dhe rrjeteve përkatëse evropiane;
- Lehtësimi i kontakteve ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe evropiane;
- Mbështetja e misioneve të biznesit dhe nismave për zhvillimin e partneriteteve.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA
Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 3.2: Bashkëpunimi me shoqatat dhe rrjetet industriale evropiane

Aktivitetet:

- Promovimi i pjesëmarrjes në rrjetet dhe platformat evropiane të sektorit të tekstileve;
- Vendosja e bashkëpunimit me organizatat përkatëse industriale evropiane;
- Nxitja e pjesëmarrjes në iniciativa të klasterëve dhe partneriteteve.

Institucioni përgjegjës: MEI
Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 3.3: Aktivitete për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (*Business-to-Business* – B2B)

Aktivitetet:

- Organizimi i aktiviteteve sektoriale për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve shqiptare dhe evropiane (B2B);
- Lehtësimi i vizitave në ndërmarrje dhe takimeve dypalëshe të biznesit;
- Mbështetja e kontakteve të mëtejshme ndërmjet bizneseve dhe krijimit të partneriteteve afatgjata tregtare;
- Promovimi i pjesëmarrjes në iniciativa për ndërmjetësimin e partneriteteve, si në format fizik ashtu edhe virtual.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA
Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 3.4: Partneritete për inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive

Aktivitetet:

- Lehtësimi i bashkëpunimit me institucionet evropiane të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
- Nxitja e pjesëmarrjes në projekte bashkëpunimi;
- Promovimi i shkëmbimit të praktikave më të mira dhe ekspertizës.

Institucioni përgjegjës: MEI
Afati kohor: 2026–2027

SHTYLLA IV: NGRITJA E KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE

Objektivi

Të forcohen kapacitetet dhe aftësitë e ndërmarrjeve dhe punëmarrësve që operojnë në zinxhirin e vlerës së sektorit të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF).

Veprimi 4.1: Programi i Trajnimit mbi Mundësitë e Tregut të Bashkimit Evropian

Aktivitetet:

- Organizimi i sesioneve të trajnimit për ndërmarrjet;
- Përmirësimi i njohurive mbi mundësitë e tregut dhe qasjet për zhvillimin e biznesit;
- Promovimi i njohurive mbi praktikat e konkurrueshmërisë dhe inovacionit.

Institucioni përgjegjës: MEI
Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 4.2: Programi për Gatishmërinë për Eksport dhe Zhvillimin e Biznesit

Aktivitetet:

- Ofrimi i trajnimeve mbi promovimin e eksporteve dhe ndërkombëtarizimin;
- Mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve në fushën e markës (*branding*) dhe marketingut;
- Promovimi i përdorimit të mjeteve digjitale për biznesin dhe i mundësive për akses në treg.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA
Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 4.3: Vizita studimore dhe aktivitete për shkëmbimin e përvojës

Aktivitetet:

- Organizimi i vizitave studimore në vende të përzgjedhura evropiane;
- Lehtësimi i shkëmbimit të përvojës me ndërmarrje dhe organizata evropiane;
- Promovimi i të nxënit nga përvojat e suksesshme evropiane.

Institucioni përgjegjës: MEI
Afati kohor: 2026–2027

7. *IMPLEMENTATION ARRANGEMENTS*

The Ministry of Economy and Innovation (MEI) shall serve as the lead institution responsible for coordinating the implementation of this Action Plan.

Implementation will be carried out in cooperation with relevant public institutions, business associations, chambers of commerce, educational institutions, development partners and private sector stakeholders.

MEI will ensure coordination among stakeholders and facilitate communication with relevant European partners and institutions.

Implementation of this Action Plan will be closely coordinated with the National Export Promotion Programme, the National Industrial Strategy, the SME Policy Document and other relevant policy initiatives to ensure complementarity, maximise synergies and avoid duplication of activities.

8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) do të monitorojë zbatimin e këtij Plani Veprimi përmes rishikimeve periodike dhe vlerësimeve të progresit.

Monitorimi do të fokusohet në arritjen e produkteve konkrete dhe rezultateve të matshme, duke përfshirë:

- Numrin e aktiviteteve promovuese të organizuara;
- Numrin e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare;
- Numrin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese të zhvilluara;
- Numrin e ndërmarrjeve përfituese nga aktivitetet e trajnimit;
- Numrin e takimeve ndërmjet bizneseve (B2B) të lehtësuara;
- Numrin e nismave të bashkëpunimit të krijuara me partnerë evropianë;
- Numrin e vizitave studimore dhe aktiviteteve të shkëmbimit të përvojës të organizuara.

Rishikime vjetore të progresit mund të ndërmerren për të vlerësuar ecurinë e zbatimit dhe për të identifikuar mundësi për forcimin e mëtejshëm të integrimit të sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) në zinxhirët evropianë të vlerës.

Progresi do të shqyrtohet çdo gjashtë muaj nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit. Raportet vjetore të zbatimit do të vlerësojnë progresin në raport me veprimet e planifikuara dhe treguesit kryesorë të performancës (KPI), do të identifikojnë sfidat e hasura gjatë zbatimit dhe, kur të jetë e nevojshme, do të rekomandojnë masa korrigjuese për përmirësimin e zbatimit të Planit.

9. REZULTATET E PRITSHME

Deri në fund të vitit 2027, zbatimi i këtij Plani Veprimi pritet të kontribuojë në:

- Rritjen e dukshmërisë së sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) në tregjet evropiane;
- Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit mbi zhvillimet dhe mundësitë në tregjet evropiane;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe evropianë;
- Rritjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve shqiptare në aktivitete ndërkombëtare të biznesit;
- Përmirësimin e aksesit në informacion dhe mundësi për krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit;
- Forcimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve dhe punëmarrësve që operojnë në zinxhirin e vlerës së sektorit TCLF;
- Integrimin më të thellë të ndërmarrjeve shqiptare në ekosistemet industriale dhe zinxhirët evropianë të vlerës.

9. TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPI)

Veprimi	Treguesi kryesor i performancës (KPI)	Vlera bazë (2025)	Objektivi (2027)*	Buxheti indikativ (lekë)	Burimi i mundshëm i financimit
Veprimi 1.1: Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare tregtare	Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare të mbështetura nga MEI/AIDA	2 aktivitete kryesore	8	**2,450,000**	Buxheti i shtetit (MEI), AIDA
Veprimi 1.2: Promovimi i Shqipërisë si destinacion për *nearshoring* dhe prodhim	Fushata ndërkombëtare promovuese dhe informuese të organizuara	2	6	**1,470,000**	Buxheti i shtetit (MEI), AIDA

Veprimi 1.3: Forumi Vjetor i Partneritetit Shqipëri–BE për sektorin TCLF	Misione biznesi, aktivitete B2B dhe forume partneriteti të organizuara	4	10	**1,960,000**	Buxheti i shtetit (MEI), Partnerë Zhvillimi
Veprimi 2.1: Programi i Informimit mbi Tregun e Bashkimit Evropian	Aktivitete ndërgjegjësuese, punëtori dhe sesione informuese të organizuara	12	25	**980,000**	Buxheti i shtetit (MEI)
Veprimi 2.1: Programi i Informimit mbi Tregun e Bashkimit Evropian	Ndërmarrje pjesëmarrëse në aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese	60	250	—	—
Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF	Platforma elektronike e informimit për sektorin TCLF funksionale	Jo	Po	**2,940,000**	IPA/projekte të financuara nga donatorët
Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF	Ndërmarrje të sektorit TCLF të përfshira në iniciativa promovimi dhe informimi	n/a	150	—	—
Veprimi 2.3: Përgatitja e materialeve praktike informuese	Materiale praktike informuese dhe udhëzues të përgatitur dhe të shpërndarë**	0	10	**490,000**	Buxheti i shtetit (MEI)
Veprimi 2.4: Përafrimi rregullator me kuadrin e BE-së për sektorin e tekstileve dhe këpucëve	Vlerësime rregullatore, konsultime me palët e interesit dhe masa zbatimi të përfunduara	0	4	**980,000**	Buxheti i shtetit (MEI), asistencë teknike IPA
Veprimi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi i partnerëve evropianë	Marrëveshje bashkëpunimi dhe partneritete me organizata evropiane dhe ndërkombëtare	10	15	**1,470,000**	Buxheti i shtetit (MEI), programet e BE-së
Veprimi 3.2: Bashkëpunimi me shoqatat dhe rrjetet industriale evropiane	Partneritete të krijuara ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare të sektorit TCLF dhe partnerëve të BE-së	n/a	20	**784,000**	Projekte të financuara nga BE-ja
Veprimi 3.3: Aktivitete për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (B2B)	Takime B2B të lehtësuara	15	100	**1,960,000**	Buxheti i shtetit (MEI), AIDA
Veprimi 3.3: Aktivitete për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (B2B)	Kompani pjesëmarrëse në aktivitetet e ndërmjetësimit dhe zhvillimit të partneriteteve	18	100	—	—
Veprimi 3.3: Aktivitete për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (B2B)	Kompani të përfshira në aktivitete partneriteti dhe rrjetëzimi	112	200	—	—
Veprimi 3.4: Partneritete për inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive	Vizita studimore dhe aktivitete të shkëmbimit të njohurive të organizuara	0	6	**1,470,000**	Partnerë zhvillimi
Veprimet 4.1–4.3: Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i aftësive	Programe trajnimi të zhvilluara	12	20	**2,940,000**	Buxheti i shtetit (MEI), partnerë zhvillimi
Veprimet 4.1–4.3: Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i aftësive	Ndërmarrje përfituese nga aktivitetet e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve	60	250	—	—

** Objektivat për vitin 2027 janë kumulative dhe përfaqësojnë rezultatet totale që pritet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit 2026–2027.*

*** Tregues i ri i propozuar për të lehtësuar monitorimin e zbatimit të veprimit 2.3.*

Buxhetet orientuese të paraqitura më sipër përfaqësojnë vlerësime paraprake të planifikimit, të përgatitura vetëm për të mbështetur procesin e planifikimit të zbatimit të këtij Plani Veprimi. Alokimet faktike vjetore do të përcaktohen në kuadër të procesit vjetor të planifikimit buxhetor të qeverisë dhe do të varen nga disponueshmëria e fondeve të buxhetit të shtetit dhe e financimeve nga burime të jashtme.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) do të koordinojë monitorimin e Treguesve Kryesorë të Performancës (KPI), në bashkëpunim me AIDA-n, shoqatat e biznesit dhe partnerët e tjerë zbatues.

11. ANEKSET

Aneksi I – Raporti i Vlerësimit të Zinxhirit të Vlerës së Sektorit të Tekstileve

Aneksi II – Raporti mbi Zhvillimin e Nismave Rregullatore dhe Rekomandimeve të Politikave

Aneksi III – Raporti mbi Zhvillimin e Masave dhe Nismave Mbështetëse

Aneksi IV – Raporti mbi Forcimin e Partneriteteve të Industrisë së Tekstileve me Bashkimin *Evropian Union Report*

URDHËR
Nr. 393, datë 3.6.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për nënshkrimin e autorizimit të prodhimit të barnave në Republikën e Shqipërisë, te znj. Eugena Tomini, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj. Eugena Tomini, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala

KËRKESË
Nr. 83/16, datë 29.6.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për projektin "Rikualifikim bllok që kufizohet nga rrugët 'Mihal Grameno', 'Todi Shkurti' dhe 'Zonja Curre'". Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "truall", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake të shpronësimit 81,384,497.90 (tetëdhjetë e një milionë e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKUALIFIKIM I BLLOKUT QË KUFIZOHET NGA RRUGËT 'MIHAL GRAMENO' – 'TODI SHKURTI' DHE 'ZONJA CURRE'"

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore									Vlerësimet për shpronësim				Shënime (kufizime hipotekore barrë mbi pasurinë etj.)	Shënime (sektori i shpronësimeve)
													"Truall"			Vlera totale (lekë)		
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale truall (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m)	Vlera (lekë)			
1	Armando Amela	Gëzim Kujtim	Gjeçi Gjeçi	Tiranë	8160	3/444	Truall	28	28	0	12	73	11.70	66,969	783,537	783,537		
2	Kol	Pjetër	Ndoci	Tiranë	8160	3/342	Truall	120	120	0	12	72	16.7	66,969	1,118,382	1,118,382	E. Mbi këtë truall ka ndërtim paleje.	
3	Ali	Ymer	Nelku	Tiranë	8160	3/441	Truall	296	296	155	12	70	28.1	66,969	1,881,829	1,881,829	E. Mbi këtë truall ka ndërtim paleje.	
4	Fatime Hilmije Naime Nurije Hamdi Halit Bedrije Hamdi Isuf Zydi Shaban Ikbale Met Haxhi Kaje Agim Enver Lirije Nazmije		Grablleshi Baxha Mevlani Sopoti Mjolli Mjolli Hyka Mjolli Mjolli Mjolli Mjolli Kodra Mjolli Mjolli Goraj Mjolli Mjolli Mjolli Osushi	Tiranë	8160	3/477	Truall	195	195	0	12	241	2	66,969	133,938	133,938		
5	Artan Anila Anxhela Shirli	Fiqiret Zydi Fatmir Fatmir	Demneri Demneri Demneri Demneri	Tiranë	8160	3/306	Truall	1198	1198	150	16	105	60.6	66,969	4,058,321	4,058,321		
6	Xhemaile Kadri Hajri Bujar	Seid Seid Seid Seid	Demneri Demneri Demneri Demneri	Tiranë	8160	3/1142	Truall	220	220	0	43	238	7.8	66,969	522,358	522,358	E. Vijon nga: vol. 12, f. 242, 243.	
7	Silvana Valbona Myzejen Lirie Enver Shaban Agim Kaje Met	Haxhi Haxhi - Mahmut Mahmut Mahmut Mahmut Mahmut Mahmut	Mjolli Mjolli Mjolli Mjolli Mjolli Mjolli Mjolli Corrja Mjolli	Tiranë	8160	3/429	Truall	307	307	0	12	39	7.8	66,969	522,358	522,358		

8	Sanije Fatbardha Gezim Jurian		Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha	Tiranë	8160	3/997	Truall	204	204	0	29	115	114.5	66,969	7,667,951	7,667,951		
9	Ppv			Tiranë	8160	3/309	Truall	250.5	250.5	106	18	137	35.6	66,969	2,384,096	2,384,096		
10	Gani Hatixhe	Bajram Haxhi	Asolli Karafili	Tiranë	8160	3/908	Truall	90	90	0	15	55	81.4	66,969	5,451,277	5,451,277		
11	Makbule Redjan	Kadri Bashkim	Toska Toska	Tiranë	8160	3/960	Truall	53	53	0	27	26	5	66,969	334,845	334,845	C. Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa në emër të Bashkim Toskes D. Në favor të fondit Besa për shumën 11.000 euro, k. hip. 1049/501, datë 18.5.2016, not. N. Xhaçka	
12	Armando	Gëzim	Gjeçi	Tiranë	8160	3/419	Truall	148	148	0	12	68	7.3	66,969	488,874	488,874	C. Pasuria rivlerësohet në shumën 9.911.412 lekë APL nr. 13836, datë 9.4.2021.	
13	Fiqirete	Jashar	Ymeti	Tiranë	8160	3/273	Truall	135.4	135.4	67	18	177	7.2	66,969	482,177	482,177		
14	Artan Kujtim Bashkim Ramazan Albert Elida Lulzim Shpresa Mimoza Suela Sajmir Arben Shefikat Gjyle Lirije Majlinda Shefqet Ledion Alma Pranvera Belina Oljana	Abdulla - Haxhi Haxhi Abdulla Abdulla Sali Reshit Namik Namik Namik Nazmi - - - Sali Sali - Nazmi Nazmi Nazmi Ramazan	Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Spaho Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Tabaku Deliallisi Tabaku Tabaku	Tiranë	8160	3/250	Truall	811	811	0	12	208	163.8	66,969	10,969,522	10,969,522	C. Blerim Mustafa Lame është pronar i pasurisë nr. 3/270, ndërtesë vol. 12, f. 226, mbi truallin 3/250. D. Kjo pasuri preket nga ndërtesa me nr. 3/250-nd, vol. 48, f. 107, përfituar me l. leg.	
15	Shtet			Tiranë	8160	3/714	Shesh	74	0	0	16	141	44.8	0	0	0		
16	Sulejman		Hoxha	Tiranë	8160	3/998	Truall	25	25	0	29	116	6.3	66,969	421,905	421,905		
17	Beqir	Met	Metaj	Tiranë	8160	3/448	Truall	237	237	40	12	136	78.2	66,969	5,236,976	5,236,976		
18	Valbona Ismete Besnik Eriola	Haxhi Musa Haxhi Haxhi	Hyka Hyka Hyka Hyka	Tiranë	8160	3/449	Truall	137	137	100	12	137	2.1	66,969	140,635	140,635		
19	Marsela Altin	Perparim Hetem	Hoxha Barjamaj	Tiranë	8160	3/1039	Truall	8	8	0	34	130	2.5	66,969	167,423	167,423	C. Rivlerësohet pasuria për shumën 535752 M. Ark	

																	datë 20.5.2017, aplikim nr. 159651.	
20	Marsela Altin	Perparim Hetem	Hoxha Barjamaj	Tiranë	8160	3/1040	Truall	32	32	0	34	131	10.8	66,969	723,265	723,265		
21	Haxhi	Shyqri	Hoxha	Tiranë	8160	3/532	Truall	764	764	0	13	200	52.6	66,969	3,522,569	3,522,569	E. L. leg nr. 127016, datë 28.10.2020, kati përdhe: sip. ndërtimi 147m², sip. shkalle 10m², sip. soc.-eko 157m², kati i parë: sip. ndërtimi 128.7m², sip. verande 11.6m², sip. banimi 140.3m². Kati i dytë: sip. ndërtimi 128.7m², sip. verande 11.6m², sip. banimi 140.3m²	
22	Mevludie Bardhyl Astrit Ardian	Zeqir Shefqet Shefqet Shefqet	Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha	Tiranë	8160	3/525	Truall	200	200	0	13	194	18	66,969	1,205,442	1,205,442	E. Mbi këtë truall ka ndërtim paleje.	
23	Sanije Fatbardha Gezim Ilirian		Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha	Tiranë	8160	3/526	Truall	200	200	0	13	195	4.2	66,969	281,270	281,270	E. Mbi këtë truall ka ndërtim paleje.	
24	Sanije Fatbardha Gezim Ilirian		Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha	Tiranë	8160	3/528	Truall	42	42	0	13	197	21.8	66,969	1,459,924	1,459,924		
25	Sanije Gezim Ilirjan Fatbardha		Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha	Tiranë	8160	3/461	Truall	170	170	0	13	88	161.9	66,969	10,842,281	10,842,281		
26	Ismail	Asllan	Tola	Tiranë	8160	3/965	Truall	28	28	0	27	56	10.6	66,969	709,871	709,871		
27	Hysni	Kadri	Qordja	Tiranë	8160	3/950	Truall	403.5	403.5	111.2	26	223	29.6	66,969	1,982,282	1,982,282	D. Në favor të Banka Credins për shumën 2.500.000 lekë k.hip. 654/238, datë 14.02.2017, not. R. Meli *e-leje* legalizimi nr. 99051, datë. 10.12.2014, godinë banimi 2 kate, sip. kati përdhe 111.2 m² sip. kati i parë 140.2 m².	
28	Vojsava Donald Adi	Myslym Gëzim Gëzim	Duka Duka Duka	Tiranë	8160	3/317	Truall	149	149	83	17	80	11	66,969	736,659	736,659		
29	Hatixhe Nazmie Fatime Shefqet Shyqyri Sulejman	Zeliha Zeliha Zeliha Zeliha Zeliha Zeliha	Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha Hoxha	Tiranë	8160	3/530	Truall	170	170	0	13	198	32.6	66,969	2,183,189	2,183,189		

30	Arban Bedri Avdulla Ikbale Sefer Sali Haxhi Sylfije	Myrteza Faik Ramazan Ramazan Ramazan Ramazan Ramazan Abdi	Maloku Zalta Hyka Meka Hyka Hyka Hyka Dinku	Tiranë	8160	3/451	Truall	224	224	0	12	139	121.5	66,969	8,136,734	8,136,734	E. Prona bllokohet sepse pjesëtimi i bërë nga gjykata përfshin dhe pronë jashtë VKKP (shish ref. 4048, v. 12, f. 135. - Vendoset sekuestro konservative për detyrimet e Haxhi Hykes.	
31	Kadri		Koburi	Tiranë	8160	3/964	Truall	24	24	0	27	55	8.5	66,969	569,237	569,237	E. Afishuar në emër të Kadri Koburi me ref. 7316, datë 8.2.2007.	
32	Jashar		Duka	Tiranë	8160	3/323	Truall	188	188	0	17	79	5.9	66,969	395,117	395,117	E. Afishuar në emër të Jashar Duka me ref. 5563, datë 30.8.2004.	
33	Sulltane Bajram	Sabri Rakip	Dervishi Dervishi	Tiranë	8160	3/322	Truall	181	181	107	16	249	12	66,969	803,628	803,628	D. Urdhër i drejtorit për kufizim. E. Me referencën nr. 5563, datë 30.8.2004, afishuar në emër të Sulltane Sabri Dervishi dhe Bajram Rakip Dervishi.	
34	Shtet			Tiranë	8160	3/715	Truall	68	68	0	16	157	23.5	0	0	0		
35	Shtet			Tiranë	8160	3/1242	Truall	19.5	0	0	60	158	9.6	0	0	0	E. Pasuria vjen nga ndarja e pasurisë nr. 3/744, vol. 24 f. 125.	
36	vol. 9, f. 38 – vol. 9, f. 83			Tiranë	8160	3/255	Pallat	881	881	881	9	38	2.7	0	0	0	E. Pallat 5-katësh, kateg. 2.	Preket 1 metërshi i pallatit
37	Shtet			Tiranë	8160	3/276	Rrugë	1087.6	1187.5	0	17	207	781.5	0	0	0		
38	Shtet			Tiranë	8160	3/1165	Shesh	1564.69	0	0	46	92	25.3	0	0	0	C. Mbi sipërfaqen e pasurisë nr. 3/1165, vol. 46, f. 96, pozicionohet pasuria nr. 3/1182/nd., vol. 47, f. 29. - Mbi këtë pasuri bie ndërtesa me nr. 3/1165-nd., vol. 49, f. 70 l. leg.	
39	Pallat			Tiranë	8160	3/303	Pallat	288	0	0	9	113	17.2	0	0	0	E. Pallat 5- katesh, kateg. 2.	Preket 1 metërshi i pallatit
40	Shtet			Tiranë	8160	3/676	Shesh	265	0	0	24	171	31.5	0	0	0		
41	Vol. 8, f. 197 – vol. 9, f. 5, vol. 29, f. 110, vol. 41, f. 116.			Tiranë	8160	3/313	Pallat	1194	1194	1194	8	197	76.7	0	0	0	E. Pallat 5-katësh, kateg. 2.	Preket 1 metërshi i pallatit
42	Pallat			Tiranë	8160	3/312	Pallat	288	288	288	9	22	41	0	0	0	E. Pallat 5-katësh, vijon në vol. 46, f. 201; 202.	Preket 1 metërshi i pallatit
43	Shtet			Tiranë	8160	3/366	Truall	115	115	0	17	240	39.5	0	0	0		
44	Shtet			Tiranë	8160	3/955	Truall	83	83	0	27	17	15.5	0	0	0	E. Për efekt të 3/271.	
45	Shtet			Tiranë	8160	3/362	Shesh	200	0	0	17	200	67.3	0	0	0		
46	Vol. 8, f. 83 – vol. 8, f. 144, vol. 10, f. 177, vol. 41, f. 127, vol. 41, f. 136.			Tiranë	8160	3/361	Pallat	1126	1126	1126	8	83	20.3	0	0	0		Preket 1 metërshi i pallatit

47	Shtet			Tiranë	8160	3/360	Shesh	304	0	0	17	199	42.7	0	0	0		
48	Shteti			Tiranë	8160	3/324	Rrugë	1027	0	0	17	201	799	0	0	0		
49	Pallat			Tiranë	8160	3/356	Pallat	821	821	821	8	145	59.5	0	0	0	E. Pasuri pallat vijon në vol. 8, f. 145, deri në vol. 8, f. 189 dhe vol. 10, f. 131 deri në vol. 10, f. 163.	
50	Shtet			Tiranë	8160	3/925	Truall	914.1	914.1	0	25	61	491.2	0	0	0	D- Mbi këtë truall është regjistruar ndërtesa me nr. pas. 3/1167/nd., vol. 46, f. 119, në bazë të l. leg., nr. 117735, datë 12.7.16.	
51	Shtet			Tiranë	8160	3/663	Trotuare	62	0	0	17	30	62	0	0	0		
52	Shtet			Tiranë	8160	3/716	Shesh	51.44	51.44	0	16	158	15.4	0	0	0		
53	Shtet			Tiranë	8160	3/1126	Shesh	2183.7	0	0	41	146	1609.7	0	0	0	E. Pasuria shtet	
54	Pranvera Embliha Muhamet Lulzim Niko Mirela Gentian	Harif Harif Arif Arif Gole Niko Niko	Bejleri Krifsa Zhilla Zhilla Simo Haxhiymeri Simo	Tiranë	8190	2/196	Truall	499.49	499.49	65.5	9	75	14.4	33,755	486,072	486,072	C. Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa 2/196-nd., vol. 49, f. 201, z. k. 8190. D. ka 5 ndërtime të paligjshme.	
55	Gazmend	Enver	Pasho	Tiranë	8190	2/517	Truall	138	138	65	32	174	14.8	33,755	499,574	499,574		
56	Besar Diana Ferit Hysni Lumturie Dritan Shaban Silvana Sokol	Sokol Nusret Qazim Qazim Qazim Shefqet Qazim Nusret Nusret	Toro Kalaja Kerçani Kerçani Muça Ago Kerçani Lluka Toro	Tiranë	8190	1/175	Truall	176	176	0	4	123	38.5	33,755	1,299,568	1,299,568	D. Ka një ndërtim pjesërisht të paligjshëm.	
57	Bedrije Saimir		Huta Huta	Tiranë	8190	1/176	Truall	44	44	0	4	124	10.8	33,755	364,554	364,554	D. Ndalim veprimesh për mungesë dokumentacioni urdhër nr. 789, datë 28.2.2012, - ka një ndërtim pjesërisht të paligjshëm. E. 1690 e vlershme për informacion pasuri e pa certifikuar.	
58	Trashëgimtarët Qemal Hutes			Tiranë	8190	1/505	Truall	41	41	0	29	116	12.8	33,755	432,064	432,064	D- Ka 1 ndërtim pjesërisht të paligjshëm E. Titulli i kësaj pronësie përfshin edhe pasurinë 1/504, e kufizuar për shkak të mbivendosjes 7104, e vlershme për informacion, pasuri e pacertifikuar.	

59	Ismail Myzejen Shyqyri	Zyber Ismail -	Kalesha Kalesha Kalesha	Tiranë	8190	1/506	Truall	160	160	0	29	118	23.8	33,755	803,369	803,369	C. Mbi këtë truall pozicionohet objekti me nr. pasurie 1/1013-nd., vol. 41, f. 60, z.k. 8190 l. leg. D- Ka 1 ndërtim pjesërisht të paligjshëm. E. Titulli i kësaj pronësie përfshin edhe pasurinë 1/504 e kufizuar për shkak të mbivendosjes 7106 e vlershme për informacion, pasuri e pa certifikuar.	
60	Ira	Foto	Gjika	Tiranë	8190	1/229	Truall	400	400	105	13	101	8.3	33,755	280,167	280,167	D- Kontratë sipërmarrjeje/akt marrëveshje ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit. E. Në bazë të aplikimit nr. 20909, datë 13.6.2024, është depozituar kërkesë padi me palë paditëse shoqërinë Lugano sh.p.k. dhe palë të paditur Vergo Dervishi, Valentina Dervishi, Eglantina Ramkaj, Ilir Gjika, Piro Zoga, me objekt detyrimin e palëve të paditur të paguajnë shumën 829317 euro dhe 1611647 all për të bllokuar tjetërsimin e pasurisë, të mos kryejnë veprime deri në pasqyrimin e kërkesë padisë në seksionin përkatës.	
61	Bujar Juli	Qerim Qerim	Ramaliu Ramaliu	Tiranë	8190	1/201	Truall	250	250	0	8	58	15.5	33,755	523,203	523,203	D. Ka një ndërtim të paligjshëm E. Për pasurinë truall nuk pajiset me certifikatë pronësie por vetëm kartelë harte sepse ka vijuar në apartamente ndarja.	
62	Fitnete		Muça	Tiranë	8190	2/92	Truall	455	455	0	4	189	6.6	33,755	222,783	222,783	D. Ndalim veprimesh për mungesë dokumentacioni	

																	urdhër nr. 780, datë 28.2.2012. - Ka një ndërtim të paligjshëm E. Regjistrohet kërkesë padia sipas vërtetimit të depozituar nga gjykata datë 17.4.2024, 1755 e vlershme për informacion pasuri e pacertifikuar.	
63	Edmond	Shaban	Hima	Tiranë	8190	2/158	Truall	405	405	159.6	5	203	2.7	33,755	91,139	91,139	E. Leje legalizimi nr. 117335, datë 21.3.2016 shtesë kati 1 kat + papafingo dhe shtesë anësore 3 kat + podrum podrumi 160.4 m² soc.-eko. kati përdhe sip. shtesë 77.6 m² soc.-eko. kati i 228.5 m² papafingo sip. shtesë 107.1 m² (verandᵉ 35.2 m²) vijon nga: vol. 5, f. 201–202 e vlershme për informacion. Ndërtesë 1 kat sip. 82.0 m² leje legalizimi nr. 117335, datë 21.3.2016, shtesë kati 1 kat + papafingo dhe shtesë anësore 3 kat + podrum podrumi 160.4 m² soc.-eko. kati përdhe sip. shtesë 77.6 m² soc.-eko. kati i 228.5 m² papafingo sip. shtesë 107.1 m² (verandë 35.2 m²).	
64	Kume Agron Merita Sadik Dilaver Zyber Gani Vjoleta Ina Besa Shpresa Aleksandër Fatbardh Aurora Arta	Ismail Bajram Bajram Bajram Qamil Qamil Qamil Qamil Tefik Kujtim Et Hem Kujtim Mehmet Tefik Tefik	Sadiku Miolli Baho Miolli Reçi Reçi Reçi Dalipi Galanxhi Kola Kola Kola Bylykbashi Bylykbashi Bylykbashi	Tiranë	8190	2/353	Truall	1745	1745	0	17	164	1.9	33,755	64,135	64,135	D. Ka 2 ndërtime të paligjshme.	

65	Shtet	Tiranë	8190	1/349	Trotuare	48	0	0	29	35	42	0	0	0		
66	Shtet	Tiranë	8190	1/347	Shesh	804	0	0	29	36	2	0	0	0	C. Mbi këtë truall pozicionohet objekti me nr. pasurie 1/1013-nd., vol. 41, f. 60, z.k. 8190 l. leg.	
67	Shtet	Tiranë	8190	1/369	Rrugë	373	0	0	28	6	36	0	0	0		
68	Shtet	Tiranë	8190	1/372	Shesh	254	0	0	29	67	140.4	0	0	0		
69	Shtet	Tiranë	8190	1/340	Rrugë	988	0	0	29	39	36.3	0	0	0	E. E vlefshme për informacion, pasuri e pacertifikuar	
70	Shtet	Tiranë	8190	1/392	Trotuare	330	0	0	29	61	152	0	0	0		
71	Shtet	Tiranë	8190	2/467	Trotuare	125	0	0	18	68	17.7	0	0	0	E. E vlershme për informacion	
72	Shtet	Tiranë	8190	2/639	Truall	32	32	0	50	153	3.2	0	0	0		
73	Shtet	Tiranë	8190	2/466	Trotuare	17	0	0	18	67	8.3	0	0	0	E. E vlershme për informacion	
74	Shtet	Tiranë	8190	2/472	Rrugë	1366.45	1366.45	0	18	73	29.2	0	0	0		
75	Shtet	Tiranë	8190	2/463	Truall	22	22	0	18	3	4.2	0	0	0	D- Kjo pasuri është e okupuar nga znj. Fitnete Qamilmuca	
76	Shtet	Tiranë	8190	2/462	Trotuare	200	0	0	18	64	141.7	0	0	0	E. E vlefshme për informacion	
77	Shtet	Tiranë	8190	2/455	Trotuare	13	0	0	18	57	6	0	0	0		
78	Shtet	Tiranë	8190	2/454	Trotuare	142	0	0	18	56	28.1	0	0	0		
79	Shtet	Tiranë	8190	2/361	Truall	32.96	32.96	0	17	176	7.4	0	0	0	D. Kjo pasuri është e okupuar nga z. Hasip Taf Omuri ka 1 ndërtim të paligjshëm.	
80	Shtet	Tiranë	8190	2/360	Truall	34.02	34.02	0	17	175	16.4	0	0	0	D. Kjo pasuri është e okupuar nga z. Hasip Taf Omuri ka 1 ndërtim të paligjshëm.	
81	Shtet	Tiranë	8190	2/453	Trotuare	23	0	0	18	55	23	0	0	0		
82	Shtet	Tiranë	8190	2/358	Truall	78	78	0	17	169	2.2	0	0	0	D. Kjo pasuri është e okupuar nga z. Muhamet Arif Zhilla.	
83	Shtet	Tiranë	8190	1/376	Rrugë	1555	0	0	29	66	1555	0	0	0		
84	Shtet	Tiranë	8190	2/475	Rrugë	1682	0	0	18	75	181.8	0	0	0		
85	Shtet	Tiranë	8190	2/452	Trotuare	40	0	0	18	54	29.8	0	0	0		
86	Shtet	Tiranë	8190	1/344	Trotuare	38	0	0	29	37	2	0	0	0		
87	Shtet	Tiranë	8190	1/380	Truall	10	10	0	26	116	3.00	0	0	0	D. Kjo pasuri është e okupuar nga z. Henrik Iljaz Billa ka një ndërtim të paligjshëm. e. Sh anësore 6034.	
SHUMA PARAPRAKE														**81,384,497.90**	**Lekë**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 880 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 146|Datë: 07.07.2026 13:34:21 +02:00|3bb17fa9-0363-4ab1-a11c-cff2cb6cd21e

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)